



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCEVE

# Strategjia Sektoriale e Financave Publike 2008 - 2013

Janar 2008

## Permbajtja

<b>I</b>	<b>Kushtet aktuale .....</b>	<b>9</b>
I.1	Konteksti nderkombetar .....	9
I.2	Konteksti i brendshem .....	9
I.3	Konteksti i administrates publike .....	10
<b>II</b>	<b>Vizioni dhe prioritetet strategjike .....</b>	<b>12</b>
II.1	Vizioni i Qeverise .....	12
II.2	Vizioni i Sektorit te Financave Publike .....	12
II.3	Prioritetet Strategjike 2008-2013 .....	12
<b>III</b>	<b>Politikat .....</b>	<b>17</b>
III.1	Permiresimi i menaxhimit te financave publike .....	17
III.2	Zgjerimi i bazes se taksueshme dhe perputhja e politikave tatimore me prioritetet kombetare.....	23
III.3	Modernizimi i menaxhimit te borxhit publik.....	26
III.4	Forcimi i performances dhe besueshmerise se administratave tatimore dhe doganore. ....	28
<b>IV</b>	<b>Rrjedhojat per burimet .....</b>	<b>36</b>
IV.1	Burimet per sektorin e Financave Publike .....	36
IV.2	Nevojat per burime ne te ardhmen .....	39
IV.3	Menaxhimi i Strategjise .....	43
<b>V</b>	<b>Pergjegjesia, Monitorimi dhe Vleresimi .....</b>	<b>45</b>
V.1	Standardet dhe proceset e monitorimit nderkombetar.....	45
V.2	Monitorimi i strategjise se Financave Publike .....	47
V.3	Pergjegjeshmeria .....	54

## Lista e Tabelave

Tabela III.1	Politikat ne sherbim te permiresimit te menaxhimit te financave publike .....	22
Tabela III.2	Politikat ne sherbim te zgjerimit te bazes tatimore dhe permiresimit te politikave tatimore .....	26
Tabela III.3	Politikat ne sherbim te modernizimit te menaxhimit te borxhit publik .....	28
Tabela III.4	Politikat ne sherbim te permiresimit te performances ne administraten tatimore .....	34
Tabela III.5	Politikat ne sherbim te permiresimit te performances ne administraten doganore .....	35
Tabela IV.1	Burimet e brendshme te parashikuara per periudhen 2008-2013 .....	36
Tabela IV.2	Shperndarja e burimeve te brendshme sipas programeve buxhetore per vitin 2007 .....	37
Tabela IV.3	Projektet e huaja per sektorin e Financave Publike .....	38
Tabela IV.4	Burimet nga financimet e huaja sipas programeve buxhetore .....	39
Tabela IV.5	Investimet sipas fushes se politikave per zbatimin e strategjise.....	40
Tabela IV.6	Aktivitetet per menaxhimin e burimeve njerezore ne kuader te Strategjise .....	41
Tabela IV.7	Struktura e personelit ne sektorin e financave publike te Shqiperise dhe Sllovenise .....	43
Tabela V.1	Indikatorët qe lidhen me permiresimin e cilesise se shpenzimeve publike .....	48
Tabela V.2	Indikatorët qe lidhen me politikat e taksave .....	51
Tabela V.3	Indikatorët qe lidhen me menaxhimin e borxhit publik .....	52
Tabela V.4	Indikatorët qe lidhen me performancen e administratave tatimore dhe doganore .....	53

## Lista e shkurtimeve

CARDS	Community Assistance for Reconstruction, Development and Stabilisation (Asistenca e Komunitetit per Rindertim, Zhvillim dhe Stabilizim)
CEFTA	Common Extended Free Trade Agreement (Marreveshje per Amendimin dhe Zgjerimin e Marreveshjes se Tregtise se Lire me Evropen Qendrore)
CFA	Country Fiduciary Assessment
DAC	Development Assistance Committee (Komiteti per Asistencen per Zhvillim)
DQAF	Data Quality Assessment Framework (Kudri i Vleresimit te Cilesise se te Dhenave)
GDSS	General Data Dissemination System (Sistemi I Pergjithshem per Shperndarjen e te Dhenave)
GFS	Government Fiscal Statistics (Statistikat Fiskale te Qeverise)
GFSM	Government Fiscal Statistics Manual (Manuali i Statistikave Fiskale te Qeverise)
HIPC	Heavily Indebted Poor Countries (Vendet e Varfera me Borxh te Larte)
IFI	International Financial Institutions (Institucionet Financiare Nderkombetare)
IPSAS	International Public Sector Accounting Standards
KBFP	Kontrolli I Brendshem Financiar Publik
LOB	Ligji Organik i Buxhetit
MCC/MCA	Millennium Challenge Corporation/Millennium Challenge Account (Sfida/Korporata e Mijevjecarit)
MIS	Sistemi I Menaxhimit te Informacionit
MPF	Menaxhimi I Financave Publike
MSA	Marreveshja e Stabilizim Asocimit
MTL	Marreveshje te Tregtise se Lire
OBT	Organizata Boterore e Tregtise
PBA	Programi Buxhetor Afatmesem
PBB	Produkti I Brendshem Bruto
PEFA	Public Expenditure and Financial Accountability (Pergjegjshmeria per Shpenzimet Publike dhe Menaxhimin Financiar)
PEIR	Public Expenditure and Institutional Review (Rishikimi I Shpenzimeve Publike dhe Institucioneve)
PRGF	Poverty Reduction and Growth Facility (Kredia per Reduktimin e Varferise dhe Rritjen Ekonomike)
ROSC	Report on the Observance of Standards and Codes (Raporti mbi Respektimin e Standarteve dhe Kodeve)
SKZHI	Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim

SIP	Sistemi I Integruar I Planifikimit
SIT	Sistemi I Informatizuar I Taksave
TAP	Tatimi mbi te Ardhurat Personale
TVSH	Tatimi mbi Vleren e Shtuar

## Qellimi

Ne kuadrin e Sistemit te Integruar te Planifikimit ne Shqiperi, Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim do te krijohet si nje permbledhje e strategjive sektoriale dhe ndersektoriale. Dokumenti qe ju paraqitet eshte strategjia e Financave Publike.

Ministria e Financave eshte pergjegjese per zhvillimin e nje strategjie sektoriale te Financave Publike qe mbulon:

- Politiken makroekonomike dhe ate fiskale, administrimin e buxhetit te shtetit, dhe administrimin financiar dhe kontrollin.
- Administrimin e të ardhurave nga taksat (ne pergjegjesine e Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve)
- Administrimin e të ardhurave nga doganat (ne pergjegjesine e Drejtorise se Pergjithshme te Doganave)

Strategjia sektoriale e Financave Publike, si cdo strategji tjeter, pasqyron:

- Programin e Qeverise
- Zbatimin e detyrimeve të Shqipërisë të ndërmarra në Marreveshjen e Stabilizim Asociimit dhe planin e anetaresimit ne NATO
- Prioritetet e Investimeve publike
- Asistencen e huaj

Ministria e Financave merr pjese gjithashtu ne zhvillimin e disa strategjive ndersektoriale, në disa fusha kryesore si:

- Decentralizimi
- Zhvillimi rajonal
- Zhvillimi rural
- Infrastruktura e teknologjise se informacionit dhe komunikimit
- Reforma e te drejtes se pronesise
- Lufta kunder krimin te organizuar
- Lufta kunder korrupsionit dhe transparencen ne qeverisje.

Percakton kontributin per SKZHI-ne, strategjia sektoriale ka per qellim te vendose lidhjen midis objektivave strategjike, me nje perspektive shtate vjecare, dhe programet e shpenzimeve ne hartuara ne kuadrin e PBA-se.

Qellimet e tjera te strategjise jane:

- te siguroje koherencen e politikave dhe sensin e orientimit afatgjate te Financave publike;
- te krijojte qartesi ne lidhje me reformat dhe proceset qe ndodhin ne sektorin publik ;
- te siguroje transparencen, perpara Parlamentit, taksapaguesve dhe partnereve sociale, sektorit financiar, partnereve nderkombetare dhe publikut ne teresi, ne lidhje me politikat qe ndiqen dhe perpjekjet qe behen nga Qeveria per krijimin e institucioneve publike profesionale dhe te besueshme.

## Cfare perfshin

Kjo strategji mbulon kater funksione baze te Qeverise qendrore: politiken fiskale, administrimin e te ardhurave, menaxhimin e buxhetit dhe te investimeve publike, dhe administrimin financiar.

Politika fiskale perfshin:

- Analizat makroekonomike dhe parashikimin e te ardhurave;
- Politiken e shpenzimeve publike;
- Politiken e taksave;
- Politiken doganore;
- Politiken e borxhit publik.

Administrimi i te ardhurave perfshin:

- Administrimin e taksave;
- Administrimin doganor.

Administrimi i buxhetit dhe investimeve publike perfshin:

- Planifikim dhe zbatimin e buxhetit;
- Menaxhimin e investimeve publike;
- Administrimin e interesave financiare te qeverise ne institucione te tjera.

Administrimi financiar perfshin:

- Funksionin e thesarit;
- Kontabilitetin e sektorit publik;
- Kontrollin e brendshem financiar publik.

## Organizimi i sektorit

Strategjia e Financave Publike mbulon kater institucione/agjenci publike per te cilat eshte pergjegjes Ministri i Financave: Ministria e Financave, Drejtoria e Pergjitheshme e Tatimeve, Drejtoria e Pergjitheshme e Doganave, Drejtoria e Pergjithshme e Pastrimit te Parave.

1) Ministria e Financave siguron mobilizimin dhe perdorimin me eficence dhe efektivitet te burimeve financiare publike me synim realizimin e qellimeve dhe objektiveve te politikave te Qeverise. Kjo perfshin politiken e te ardhurave, politiken e buxhetit dhe zbatimin e tij, menaxhimin e borxhit, menaxhimin dhe kontrollin e shpenzimeve dhe menaxhimin e pasurise publike. Ministria e Financave ka gjithashtu nje rol te pergjithshem keshillues, ne interes te Qeverise, ne promovimin e eficences, performances se larte dhe mireqeverisjes financiare ne te gjithe sektorin publik, perfshire dhe ato institucione financiare ne te cilat Qeveria merr pjese.

Ministria e Financave eshte e organizuar ne 5 drejtori te pergjithshme per:

- Buxhetin: perfshin drejtorine e analizave, politikave dhe programimit buxhetor, drejtorine e monitorimit dhe menaxhimit te buxhetit, dhe drejtorine e menaxhimit te investimeve publike.
- Thesarin: qe perfshin drejtorine e thesarit, drejtorine e kontabilitetit dhe drejtorine e administrimit te prones publike, si dhe deget e thesarit ne rrethe.

- Borxhin: qe perfshin drejtorine e borxhit me instrumenta financiare dhe drejtoria e borxhit te kontraktuar per projektet me financim te huaj.
- Politiken Makroekonomike dhe Fiskale: qe perfshin drejtorine e makroekonomise dhe drejtorine e politikave fiskale. Kjo drejtori eshte pergjegjese per parashikimet makroekonomike, hartimin e politikave fiskale, kryerjen e analizave perkatese si dhe plotesimin dhe shperndarjen e Statistikave Fiskale te Qeverise (GFS).
- Sherbimet: qe perfshine drejtorine e marredhenieve me jashte dhe integritet europian, drejtorine e teknologjise se informacionit, drejtorine e personelit dhe drejtorine e legjislacionit.
- Auditimi i Brendshem: qe perfshin drejtorine e harmonizimit te metodologjise dhe drejtorine e auditimit, mbikqyrjes dhe investigimit.

2) Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve eshte institucioni qendror i taksave ne Shqiperi. Ajo eshte pergjegjese per mbledhjen dhe administrimin e te gjitha taksave kombetare, si dhe te kontributeve shoqerore dhe shendetesore. Misioni i DPT eshte mbledhja me eficence dhe efektivitet e te ardhurave tatimore, duke i ofruar taksapaguesit nje sherbim cilesor dhe duke i ndihmuar te shlyejne detyrimet ndaj shtetit. Eshte e perbere nga Drejtoria e Pergjithshme, 36 dege lokale, dhe Dega e Taksapaguesve te Medhenj.

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve eshte e organizuar ne drejtori:

- Drejtoria e Auditit te Brendshem, Drejtoria e Apelimit Tatimor, Sektori i Investigimit te Brendshem (Antikorrupsioni), Njesia Ligjore, Drejtoria e Kontabilitetit Tatimor, Drejtoria e Burimeve Njerezore, Drejtoria e Sherbimit dhe Administrates, Drejtoria e Teknologjise se Informacionit, Drejtoria Teknike, Drejtoria e Marredhenieve me Jashte dhe e Projekteve te Vecanta, Drejtoria e Procedurave, Drejtoria e Sherbimeve dhe e Regjistrimit te Tatimpaguesve, Drejtoria e Investigimit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor dhe Drejtoria e Policise Tatimore.
- Deget tatimore ne rrethe, te cilat jane ne proces ristrukturimi ne Drejtori Rajonale

3) Drejtoria e Pergjithshme e Doganave ka si mision te saj: i) sigurine e tregjeve dhe te popullates (mbrojtja e konsumatoreve, mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e kufijve kombetare) nepermjet mbikqyrjes eficente te doganave dhe bashkepunimit brenda dhe jashte vendit; ii) mbledhjen e taksave qe administrohen nga Doganat; iii) krijimin e kushteve te pershtatshme per zhvillimin e biznesit, nepermjet aplikimit te metodave moderne te punes dhe krijimit te “Doganave elektronike”.

Drejtoria e Pergjithshme e Doganave perbehet nga tre departamente:

- Departamenti Administrativ perfshin Drejtorite Finances; Organizimi Personelit Trainimit dhe Etikes; Logjistikes; Kompjuterizimit; Departamenti Teknik perfshin Drejtorite e Procedurave dhe Vjeljes se Detyrimeve; Juridike; Tarifes, Origjines, Vleres, Akcises, Tvsh; Laboratori Doganor, Statistikes; Departamenti Operativ Hetimor perfshin drejtorite e Anti-kontrabandes;
- Hetimit; Inteligjences; Kontrolleve A-posteriori; dhe
- Tre drejtori rajonale dhe 17 Dege Doganore.

4) Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave e ushtron aktivitetin e saj si nje agjenci e vecuar nga struktura e Ministrise se Financave, dhe ka pavaresi operacionale dhe organizative. Kjo drejtori i raporton ne menyre direkte Ministrit te Financave. Pjesa e strategjise qe perfshin kete drejtori do te permbahet ne strategjine ndersektoriale mbi luften kunder krimit te organizuar, trafikut dhe terrorizmit.



## I KUSHTET AKTUALE

### I.1 Konteksti nderkombetar

Gjatë shtatë viteve në vijim ndikimin më të madh në orientimin e financave publike do ta ketë realizimi i objektivave të integritit evropian. Politika fiskale dhe administrimi i financave publike do të vazhdojnë të orientohen drejt adaptimit të parimeve dhe legjislacionit evropian. Meqenese mbështetja financiare dhe teknike nga institucionet financiare ndërkombëtare do të vijë duke u pakësuar gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë, është shumë i rëndësishëm një mobilizim i mëtijshëm i burimeve të brendshme për realizimin e reformave në fushën e financave publike.

### I.2 Konteksti i brendshem

Pas një periudhe permiresimi dhe stabilizimi të shpejte dhe të vazhdueshem të situatës makroekonomike dhe fiskale dhe uljes së borxhit publik, sektori I financave publike në Shqipëri po përballë me sfida të reja, adresimi i të cilave është kusht për arritjen e objektivave të integritit dhe të zhvillimit.

Rregullimet fiskale të kryera që nga fillimet e viteve '90, që ulen ndjeshëm nivelin e borxhit nga 80% në 55% të PBB-së, paten si efekt negativ anësor uljen e cilësive të shpenzimeve publike, nepermjet pakesimeve drastike dhe të pa balancuara të shpenzimeve kapitale dhe të atyre korente jo për paga, dhe uljen e fleksibilitetit të rialokimeve.

Aftësia e qeverisë për të rritur fondet për shpenzime është e kushtezuar nga niveli ende i lartë i borxhit publik dhe i kostos së tij.

Shqipëria mbështetet gjerësisht në burimet e brendshme për financimin e deficitit, në nivelin e rreth 76 përqind për vitin 2007. Edhe në krahasim me vendet e tjera, raporti i borxhit të brendshëm me PBB është relativisht i lartë. Rreth 70% e stokut të borxhit publik në Shqipëri është në instrumenta afatshkurter të brendshëm dhe i përqendruar në pak investitore (institucione) vendas, kryesisht banka. Kjo situatë rrit rrezikun e rifinancimit dhe koston e borxhit publik.

Për realizimin e planeve të zhvillimit, qeveria ka nevojë për rritje të qëndrueshme të të ardhurave. Reforma të rëndësishme janë bërë në drejtim të uljes së evazionit fiskal. Të ardhurat buxhetore totale në Shqipëri janë rreth 27% të PBB-së, për vitin 2007. Ka pasur një rritje nga 24,8% të PBB-së në vitin 2002, në 25,7% në vitin 2006 dhe 27% në 2007, pas përmirësimeve në arkëtimin e tatimeve, me gjithë reduktimin e tarifave doganore në zbatimin e marrëveshjeve të dyanshme të tregtisë së lirë dhe angazhimeve të tjera. Viti 2007 shënon vitin në të cilin Shqipëria ka bërë reduktimet më të larta të nivelit të barres fiskale të realizuar ndonjëherë, dhe përmirësime të rëndësishme të kuadrit ligjor, tatimor dhe doganor për formalizimin e ekonomisë shqiptare.

Baza e taksueshme është ende e ngushtë dhe le hapësira për evazion dhe shmangie taksash. Ka probleme mos raportimi në lidhje me të punësuarit dhe me pagat, për mbajtjen në burim të tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, edhe pse vlen të theksohet se viti 2007 ishte viti i reformave të rëndësishme në fushën e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, në drejtim të rritjes së formalizimit të punës. Administrimi i kontributeve dhe i tatimit mbi të ardhurat nuk janë plotësisht në përputhje, dhe kjo rrit rrezikun e papajtueshmërisë me këto detyrime. Politika e taksave,

perfshire dhe llojet dhe numrin e taksave qe paguhen ne vend, nuk eshte plotesisht e pershtatur me standarte nderkombetare dhe duhet te permiresohet dhe fuqizohet lidhja me objektivat strategjike kombetare. Te ardhurat e mbledhura nga doganat do te jene ne renie te vazhdueshme, per shkak te reduktimit/eliminimit te tarifave kundrejt BE-se, ne kuader te zbatimit te MSA.

Administrata tatimore dhe ajo doganore i jane nenshtuar nje procesi reformimi qe synon te modernizojte dy agjencite me te rendesishme per ekonomine shqiptare. Disa nga sfidat me te rendesishme jane ato qe lidhen me zbatimin transparent dhe me korrektesi te kuadrit ligjor tatimor dhe doganor, ofrimi i nje sherbimi me standarte te larta cilesie, kompjuterizimi i plote i dy administratave, menaxhimi mbi baze performance dhe standartesh (per shembull menaxhimi i pajtueshmerise vullnetare te tatimpaguesve) dhe jo mbi bazen e realizimit te te ardhurave, etj.

Rritja ekonomike dhe qendrueshmeria e saj kerkon, pervec niveleve te larta te investimeve, edhe cilesi dhe eficence te tyre. Evidenca e deritanishme eshte e nje cilesie jo te kenaqshme te shpenzimit publik. Ne vecanti, me shume arritje priten ne ndertimin e infrastrukturave te reja (standartet ne sektoret e energjise elektrike, ujit, telekomunikacioneve mbeten te uleta ne krahasim me standartet europiane, me pasoja negative per klimen e investimeve), dhe investimet kapitale te realizuara kane patur kosto te larte, cilesi te ulet ndertimi dhe mungese mirembajtje. Nga ana tjetere, rritja e eficences se shpenzimeve do te implikojte rialokime te burimeve te disponueshme - brenda sistemit arsimor drejt arsimit te detyruar dhe atij te mesem, rialokimi i shpenzimeve buxhetore drejt arsimit dhe shendetesise - me qellim arritjen e objektiveve te rritjes ekonomike dhe uljes se varferise. Permiresimi i kontrollit te shpenzimeve publike dhe rritja e qendrueshmerise se fluksit te te ardhurave publike do te rezultojte ne permiresimin e planifikimit dhe administrimit te shpenzimeve.

Nje nga iniciativat me te rendesishme te programit te Qeverise eshte decentralizimi. Ne kuader te decentralizimit fiskal, qe implikon kalimin e kompetencave ne lidhje me taksimin nga pushteti qendror ne ate vendor, financat vendore kane pesuar ndryshime te medha, duke filluar nga aprovimi ne fund te 2002 te paketes se re fiskale per sistemin e taksave vendore. Ne kuader te kesaj reforme fiskale qe synon rritjen e financimit vendor dhe te autonomise fiskale te pushtetit vendor, ne fillim te vitit 2007 mbledhja dhe administrimi i taksas vendore mbi biznesin e vogel kaloi teresisht nen pergjegjesine e pushtetit vendor. Thelbi i suksesit te kesaj reforme qendron ne bashkepunimin e frytshem midis dy pushteteve per uljen e evazionit dhe rritjen e te ardhurave. Thelimi i decentralizimit fiskal duke lidhur delegimin e funksioneve me fondet perkatese do te perbeje nje nder prioritetet e viteve ne vijim. Ne marreveshjet qe do te arrihen me pushtetin vendor, pushteti qendror do te mbaje ne konsiderate interesat e tij persa i perket shpenzimeve, kontabilitetit, stabilitetit fiskal.

### 1.3 Konteksti i administrates publike

Ne kete kuader, jane marre vendime te rendesishme ne lidhje me forcimin e disa proceseve kyce dhe te racionalizimit te pergjegjesive te institucioneve te ndryshme te perfshira ne financat publike. Disa nga keto ndryshime jane:

- Pergjegjesia e re e Ministrise se Financave si institucioni udheheqes ne hartimin e politikave fiskale, duke realizuar nje ndarje te qarte te pergjegjesive ndermjet administratave te te ardhurave dhe Ministrise se Financave.
- Transferimi i pergjegjesise per menaxhimin e investimeve publike nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Nergjtikes tek Ministria e Financave.

- Transferimi i pergjegjesise se mbikqyrjes dhe rregullimit te sektorit financiar jo bankar nga Ministria e Financave tek nje organ i ngarkuar posacerisht me kete detyre.
- Transferimi li roleve te tjera rregullatore te tregut nga Ministria e Financave tek Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes.
- Transferimi i pergjegjesise se Planifikimit Strategjik Kombetar nga Ministria e Financave tek Departamenti i Bashkerendimit dhe Koordinimit te Strategjive ne Keshillin e Ministrave.
- Ndarja nga struktura e Ministrise e drejtorise se Parandalimit te Pastrimit te Parave, me detyren e mbledhjes, analizimit dhe shperndarjes tek agjensite e zbatimit te ligjit te informacionit financiar, me qellim parandalimin dhe luften kunder pastrimit te parave dhe financimit te mundshem te aktiviteteve terroriste.
- Zhvillimi i Programit Buxhetor Afatmesem dhe draftimi i ligjit te ri Organik te Buxhetit, qe me hyrjen ne fuqi do te ndryshoje arkitekturen e buxhetimit, menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe pergjegjshmerise ne sektorin publik, si dhe do t'i siguroje Ministrise se Financave me shume mjete ne dispozicion dhe me shume pergjegjesi per garantimin e performances afatmesme per te gjithë sektorin publik.

Kjo analize perforcohet edhe nga vleresime te pavarura te sektorit publik ne Shqiperi te cilat kane dale ne perfundimin se:

- Menaxhimi i financave publike duhet te orientohet kundrejt standardeve nderkombetare dhe rajonale<sup>1</sup>.
- Shpenzimet publike jane te nje cilesie te ulet ne lidhje me investimet kapitale fizike dhe njerezore dhe ne lidhje me mirembajtjen e infrastruktures.
- Niveli i borxhit publik (ne 55% te PBB-se) dhe kostoja e sherbimit te tij mbeten te larta.<sup>2</sup>
- Mobilizimi dhe mbledhja e te ardhurave nga taksat dhe kontributet duhet te jete e orientuar drejt formalizimit te ekonomise dhe permiresimit te klimes se biznesit me fokus permiresimin e cilesise se sherbimit ndaj taksapaguesit dhe mirëadministrimit të sistemit fiskal
- Politikat e burimeve njerezore ne te tre organizatat e sektorit te financave publike jane ne nivel jo te kenaqshem kundrejt praktikave te mira te pranuar gjeresisht.

---

<sup>1</sup> Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA)

<sup>2</sup> Public Expenditure and Institutional Review

## II VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

### II.1 Vizioni i Qeverise

Vizioni i Qeverise per vitet ne vijim eshte rritje e shpejte, e qendrueshme dhe gjithepershiresë e ekonomise shqiptare, dhe integrim te suksesshem European dhe Euro Atlantik. Ky vizion perfshin<sup>3</sup>:

- Mbajtja e një ritmi rritjeje ekonomike mesatare më të lartë se 6% në vit dhe me tendencë rritëse duke arritur në 7 %.
- Ruajtja e stabilitetit makroekonomik nëpërmjet konsolidimit të mëtejshëm fiskal, uljes së vazhdueshme të borxhit të brendshëm, përmirësimit të balancës korrente dhe hartimit të politikës fiskale në përputhje me politikën monetare
- Ulja e nivelit të taksave dhe ruajtja e nivelit 27-28 % të PBB-së të të ardhurave publike, krahas reduktimit të informalitetit dhe mirëadministrimit të sistemit fiskal
- Krijimi i klimës së biznesit të favorshme për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja.
- Rritja e nivelit te decentralizimit fiskal, me decentralizimin e metejshem te funksioneve te perbashketa.

Per arritjen e ketij vizioni, Qeveria eshte angazhuar:

“...te reformoje thellesisht planifikimin e financave publike, duke zbatuar Sistemin e Integruar te Planifikimit, i cili do te siguroje harmonizimin e hartimit te buxhetit vjetor me kuadrin e Planifikimit te Buxhetit Afatmesem, me Strategjine Kombetare per Zhvillimin dhe Integrim dhe me Procesin e Stabilizim Asocimit ne BE, si edhe me politika dhe strategji te tjera prioritare... “

### II.2 Vizioni i Sektorit te Financave Publike

*Sektori i financave publike do të jetë i orientuar profesionalisht drejt mobilizimit dhe përdorimit me eficencë, efikasitet, transparencë dhe integritet, të burimeve financiare të vendit, në përputhje me politiken dhe prioritetet e Programit të Qeverisë dhe Strategjise Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.*

Administra Tatimore dhe Doganore, si dy institucione me rendesi te madhe per ekonomine shqiptare, do te zbatojne politikat e te ardhurave me profesionalizem, integritet dhe ndershmeri, me nje standard qe krijon besueshmeri tek qytetaret, dhe kredibilitet me partneret e qeverise dhe komunitetin e biznesit vendas dhe te huaj.

### II.3 Prioritetet Strategjike 2008-2013

Strategjia e Financave Publike per periudhen 2008-2013 eshte te mobilizojë burimet per te realizuar ne menyren me te mire te mundshme objektivat e brendshme dhe nderkombetare te Shqiperise.

---

<sup>3</sup> Programi I Qeverise Shtator 2005

Kater shtyllat e kesaj strategjie jane:

1. Përmirësimi i menaxhimit të financave publike sipas standarteve ndërkombëtare
2. Zgjerimi i bazës së taksueshme dhe harmonizimi i politikave fiskale me përparësitë kombëtare
3. Modernizimi i menaxhimit të borxhit publik.
4. Rritja e performancës dhe besueshmërisë të administratave tatimore dhe doganore.

Kjo strategji sektoriale përfshin gjithashtu një plan strategjik të brendshëm për ngritjen e kompetencave organizative të nevojshme për arritjen e objektivave strategjike.

Sfidat kryesore për sektorin e financave publike do të jenë:

- Ruajtja e stabilitetit makroekonomik.
- Përmirësimi i menaxhimit të financave publike sipas standardeve ndërkombëtare.
- Përmirësimi i planifikimit dhe i cilësisë së shpenzimeve publike.
- Formulimi i politikave tatimore dhe doganore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë.
- Ulja e nivelit të borxhit publik në përqindje të PBB-së dhe e kostos së shërbimit të tij.
- Thëllimi i reformës në politikën e burimeve njerëzore në të gjithë administratën e financave publike, dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative.
- Përmirësimi i menaxhimit të administratës tatimore dhe doganore duke u bazuar në realizimin e të ardhurave me profesionalizem, integritet dhe ndershmëri, me një standard që krijon besueshmëri tek qytetaret, dhe kredibilitet me partnerët ndërkombëtar dhe komunitetin e biznesit, vendas dhe të huaj.
- Përmirësimi i vlerësimit të performancës të administratës tatimore dhe doganore, duke u bazuar kryesisht në aftësitë profesionale dhe në cilësinë e shërbimit ndaj taksapaguesve, me fokus të veçantë inkurajimin e vetedeklarimit vullnetar të detyrimeve tatimore.
- Përmirësimi i sistemit të administrimit financiar, të auditit të brendshëm, të raportimit financiar dhe të llogaridhënies.
- Lufta ndaj transaksioneve jo-ligjore.

### II.3.1 Përmirësimi i menaxhimit të financave publike

Marrja e rezultateve me të mira nga shpenzimet publike kërkon përmirësime në shtatë fusha:

1. Përmirësimi i parashikimeve makroekonomike dhe fiskale për të shmangur mbivlerësimet apo nënvlerësimet e burimeve buxhetore.
2. Përmirësimi i programimit buxhetor afatmesëm dhe vjetor, duke mbështetur fuqimisht shpërndarjen e burimeve në fushat me përparësi kombëtare, duke forcuar disiplinën fiskale, rritur efikasitetin dhe efektivitetin e shpenzimeve publike, si edhe duke u bazuar në një kostim real të politikave.
3. Përmirësimi i planifikimit dhe menaxhimit të investimit publik, nëpërmjet rritjes së madhësisë mesatare të projekteve dhe pakësimit të numrit të tyre duke u mbështetur në procedurat e reja të menaxhimit të investimeve publike, që sigurojnë përmirësimin e procedurave të identifikimit, vlerësimit dhe miratimit të projekteve.

4. Thellimi i procesit te decentralizimit fiskal, nepermjet rritjes se burimeve lokale nga transferimi i taksave te reja, mireadministrimi i atyre ekzistuese dhe rritja e transfertes se buxhetit te shtetit, njekohesisht zbatimi i të drejtes se huamarrjes lokale dhe rritja e transparencës dhe objektivitetit në shpërndarjen e burimeve drejt njësive të pushtetit vendor.
5. Përmirësimi i cilesise së raportimit, transparencës në zbatimit të buxhetit dhe menaxhimin me te mire te fondeve publike ndërmjet modernizimit te sistemit te thesarit dhe zbatimit të projektit te kompjuterizimit te tij.
6. Hartimi dhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe krijimi i një sistem auditimi dhe të kontrollit te brendshëm financiar efektiv, dhe të pavarur në të gjithë sektorin publik.
7. Përmirësimi i luftës ndaj transaksioneve jo-ligjore duke u bazuar në; thellimin dhe zgjerimin e luftes kunder pastrimit te parave dhe financimit të terrorizmit, ndërmjet hartimit të politikave kombetare parandaluese; përmirësimin e bashkepunimit nderinstitucional kombetar si edhe me homologët nderkombetar; ndertimin e një platforme të infrastruktures se teknologjise se informacionit dhe rritjen e kapaciteve njerezore.

### II.3.2 Zgjerimi i bazës tatimore dhe harmonizimi i politikave fiskale me përparësitë kombëtare.

8. Politika tatimore do të ruajë një ekuilibër ndërmjet sigurimit të të ardhurave për shpenzimet buxhetore, përmirësimin të klimës së investimeve private vendase dhe te huaja dhe ruajtjes së barazisë sociale. Shtylla kryesore e zhvillimit të këtij synimi do të jetë ruajtja e një niveli të ulët të taksave shoqëruar paralelisht me uljen e evazionit fiskal, dhe zgjerimin e bazeve se taksueshme dhe shpërndarjen më të drejtë e pa deformime te barres tatimore. Mekanizmat kryesore per zbatimin e kesaj politike do te jene:
9. Zbatimi i taksës së sheshtë, që do të thjeshtojë administrimin, do të rrisë formalizimin e ekonomisë, dhe do të nxisë investimet.
10. Përmirësimet në sistemin e kontributeve të sigurimeve shoqërore për të rritur numrin e kontribueve në skemë.
11. Rishikimi i sistemit të taksave me fokus të veçantë shkurtimin e listës së taksave të aplikueshme në Shqipëri; kthimin e shume prej tyre në tarifa shërbimi dhe transferimin e disa taksave nacionale në taksat vendore.
12. Njesimi gradual i politikave për tatimet indirekte me standartet europiane.
13. Thjeshtimi i akteve tatimore ligjore dhe nënligjore.
14. Përmirësimet administrative me qëllim uljen e pengesave burokratike, shmangien e kontakteve taksapagues - inspektor tatimor, dhe orientimit drejt e-filing.

### II.3.3 Rritja e performancës dhe kredibilitetit të administratave doganore e tatimore.

Politikat në lidhje me këtë qëllim strategjik synojnë të modernizojnë dy administratat, të rrisin efikasitetin operativ të tyre, të nxisin shlyerjen vullnetare të detyrimeve. Këto politika janë:

15. Analiza e rrisit të tatimpaguesve për identifikimin e burimeve kryesore të evazionit tatimor dhe uljen e tij; rritja e arketimeve vullnetare të detyrimeve tatimore; forcimi i kontrollit dhe monitorimit të regjistrimit, deklarimit dhe pagesës së detyrimeve; thjeshtimi i procedurave të deklarimit të pagesës; dhe përmirësimi në mbledhjen dhe analizën e informacionit
16. Rritja e cilësisë së shërbimit për tatimpaguesit dhe e kredibilitetit ndaj tyre, duke përmirësuar në këtë mënyrë klimën e biznesit. Për këtë:
  - *në administratën tatimore*: do të rritet shërbimi cilësor ndaj tatimpaguesve, me fokus të veçantë në zonat ku është përqëndruar numri më i madh i tatimpaguesve; do të përmirësohet dhe thjeshtohet sistemi i apelimit, duke reduktuar shkallët e apelimit administrativ dhe duke krijuar një sistem profesional të apelimit gjyqësor; do të përmirësohet funksionimi i zyrës së tatimpaguesve të mëdhenj, duke u shndërruar në një zyrë shërbimi për të gjithë; do të ristrukturohet ndarja territoriale e administratës ndërmjet krijimit të drejtorive rajonale me funksione të plota bazë dhe krijimin e qendrave të shërbimit të tatimpaguesve në zonat ku numri i tyre është i ulët; do të krijohet dhe fuqizohet shërbimet e investigimit dhe hetimit tatimor; do të zgjerohet me tej mundësia e deklarimit dhe pagësës elektronike të detyrimeve tatimore, si edhe do të zgjerohet përpunimi i informatizuar i deklaratave tatimore, dhe shkëmbimi i informacionit me tatimpaguesit (e-taxation).
  - *në administratën doganore*: do të zbatohet programi i doganës elektronike (e-customs), për të thjeshtuar paraqitjen e deklaratave doganore dhe për të ofruar një mundësi më të shpejtë për lehtësimin në marrjen e informacionit.
17. Garantimi i mbrojtjes së tregut, duke respektuar angazhimet ndërkombëtare për administratën doganore, siç është Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit apo rezolutat e Organizatës Botërore të Doganave për sigurinë dhe thjeshtimin e tregtisë.
18. Fuqizimi i performancës, i menaxhimit të kontrollit dhe i auditimit të brendshëm në administratat tatimore e doganore, për të luftuar korrupsionin dhe zbatimin jo të drejtë të rregullave e procedurave, përmes hetimeve të pavarura dhe procedurave ankimore.
19. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në administratat tatimore dhe doganore.
20. Informatizimi i plotë i dy administratave.

### II.3.4 Modernizimi i menaxhimit të borxhit publik.

Aktiviteti i borxhit publik mbështet strategjinë, nepermjet zhvillimit të tregut financiar të brendshëm dhe hyrjes në tregun ndërkombëtar të kapitaleve. Përbërësit kryesorë të kësaj politike janë:

21. Menaxhimi i rrisqeve të huamarrjes së brendshme dhe e kostos së saj duke zgjatur periudhën e maturimit të huamarrjes së brendshme dhe peshën specifike të borxhit me

maturim afatgjatë, nëpërmjet një tregu të brendshëm më kompetitiv për bonot e thesarit; diversifikimit të instrumenteve dhe investuesve, si dhe emetimit të obligacioneve qeveritare pesë dhe shtatë-vjeçare në leke dhe në monedhë të huaj. Zgjerimi i instrumentave afatgjatë të huamarrjes përveç atyre 7 vjeçar të emetuara në fund të vitit 2007.

22. Krijimi i një strukture më të mirë midis borxhit të brendshëm dhe borxhit të jashtëm, duke rritur peshën specifike të borxhit të jashtëm nëpërmjet kryerjes së një vlerësimi (rating) ndërkombëtar kredimarrjeje, që është realizuar në Qershor 2007 dhe, që do të mundësojë hyrjen në tregun e Eurobonove.
23. Zhvillimi i një sistemi elektronik *'delivery-versus-payment'* (livrim kundrejt pagesës) për letrat me vlerë të qeverisë, i cili do të integrohet me ankandet e letrave me vlerë.
24. Krijimi i një sistemi të integruar për menaxhimin e borxhit dhe fuqizimi i kapacitetit profesional e teknologjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit për kryerjen e analizave të rrezikut dhe të qëndrueshmërisë.



### III POLITIKAT

Ky kapitull rendit politikat kryesore dhe me te rendesishme per arritjen e objektivave strategjike te sektorit per gjashte vitet e ardhshme. Ky eshte nje proces strategjik i rinovueshem dhe politika me te detajuara per vitet qe do te vijne do te hartohen ne vijim.

#### III.1 Permiresimi i menaxhimit te financave publike

Per te nxjerre rezultate me te mira nga shpenzimet publike do te behen permiresime ne gjashte fusha kryesore.

##### III.1.1 Permiresimi i parashikimeve makroekonomike dhe fiskale.

*Rritja e kapaciteteve ne Ministrine e Financave per parashikimin realist te treguesve makro dhe fiskale, sipas skenareve te mundshem te zhvillimeve ekonomike, qe marrin ne konsiderate faktore te ndryshem risku.*

##### III.1.2 Permiresimi i planifikimit dhe menaxhimit te investimeve publike

*Zbatimi i planit te punes per permiresimin e menaxhimit te investimeve publike, qe perfshin marreveshjet institucionale, procedurat, sistemet e informacionit, dhe burimet njerezore dhe kapacitetet.*

*Fuqizimi i procesit per perzgjedhjen, planifikimin, buxhetimin dhe menaxhimin e investimeve publike:*

- Racionalizimi i portofolit te projekteve te financuara nga fondet e buxhetit te shtetit, nepermjet rritjes se madhesise mesatare te tyre dhe pakesimit te numrit;
- Integrimi i planifikimit te investimeve me PBA-ne. Sigurimi i integritit te plote te menaxhimit dhe planifikimit te investimeve publike me procedurat e PBA-se planifikimin e shpenzimeve dhe investimeve te programeve te ministrive te linjes/institucioneve te tjera buxhetore.
- Vleresim i standartizuar. Hartimi dhe zbatimi i procedurave per identifikimin, vleresimin dhe aprovimin e projekteve, per projektet e financuara me fonde te brendshme dhe te huaja, dhe lidhja e tyre me procesin e PBA-se.
- Analiza kosto-perfitim per investimet kryesore. Aplikimi i analizave kosto-perfitim dhe/apo kosto-efektivitet si kusht per vleresimin e investimeve te medha.
- Adoptimi i aprovimit te financimit shumevjecar per koston e plote per te gjitha projektet e investimeve publike.
- Parashikimi i mirembajtjes. Rritja dhe plotesimi i financimeve per mirembajtjen e rrjetit te infrastruktures.

##### III.1.3 Permiresimi i sistemit te menaxhimit te shpenzimeve publike

*Forcimi i programimit afatmesem buxhetor. Hartimi dhe miratimi i ligjit te ri per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, do te mundesoje perafrimin me standartet europiane dhe me standartet e transparences fiskale te Fondit Monetar Nderkombetar rreth buxhetimit mbi baze performance. Zbatimi i procesit te udhezimeve, drejtimit, mbeshtetjes dhe*

trajnim, për të rritur kapacitetet për planifikimin, buxhetimin, kostimin, dhe kontabilitetin në Ministri dhe në të gjitha ministrat e linjes.

*Rritja e vëmendjes mbi tavanet e burimeve të PBA-së për vitet e ardhshme, në mënyrë që ato të japin një bazë realiste dhe të besueshme për planifikimin e buxhetit afatmesëm në nivel sektorial dhe në nivel programi.*

*Fuqizimi i lidhjes ndërmjet buxhetit vjetor, PBA-së dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.*

*Përmirësimi i mëtejshëm i klasifikimit të buxhetit të bazuar në programe, në mënyrë që të forcohet lidhja direkte ndërmjet politikave sektoriale dhe buxhetit, paralelisht me kapacitetet e rritura.*

*Zbatimi i Ligjit mbi Menaxhimin e Sistemit Buxhetor menjëherë pas aprovimit.*

*Zbatimi i prokurimit shumëvjeçar me vlerë të plote, sidomos për projektet e investimeve kapitale.*

*Përmirësimi i rregullores për transfertat. Hartimi i procedurave të qarta dhe transparente për transfertat dhe rishikimin e buxhetit vjetor, për të pajisur përdoruesit e buxhetit me fleksibilitetin e përshtatshëm, por duke ruajtur integritetin e procesit të buxhetit.*

*Fuqizimi i përgjegjshmërisë, nëpërmjet angazhimit me strategjik dhe të dobishëm të Parlamentit mbi çështjet e Menaxhimit të Financave Publike.*

- Adoprimi i ciklit të buxhetit në mënyrë që të dedikohet me shumë kohë planifikimit të buxhetit duke mundësuar kështu një dokument me cilësor për shqyrtim në Kuvend;
- Përfshirja e Komisionit Parlamentar për Çështjet Ekonomike dhe Fiskale në çështjet që lidhen me mënyrën e raportimit të buxhetit.

### III.1.4 Fuqizimi i kontrollit dhe menaxhimit të Thesarit

Disa nga politikat që synojnë përmirësimin në përgjithësi të menaxhimit të thesarit janë:

*Perditesimi i plote i rregullores së Thesarit.*

*Dizenjimi dhe zbatimi i sistemit të kompjuterizuar të Menaxhimit të Thesarit. Zbatimi do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë dhe do të përfshijë sistemin e tatimeve dhe doganave, si edhe institucionet e tjera buxhetore.*

*Formulimi dhe shpërndarja e manualit për sistemin e kompjuterizuar të thesarit, në bashkëpunim me PNUD dhe projektin ORACLE.*

*Levizja e fokusit drejt menaxhimit dhe kontrollit të detyrimeve si edhe drejt cash-it dhe pagesave.*

*Zhvillimi i praktikës së parashikimit të cash-it*

Me poshtë janë përmendur disa nga politikat që prekin në vecanti dy fushat e menaxhimit të thesarit: ekzekutimi i buxhetit të shtetit dhe menaxhimi i aseteve financiare të zotëruara nga qeveria.

Përmirësimi i ekzekutimit të buxhetit nëpërmjet:

- Ngritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i ndjeshëm i procesit të alokimit të kufirit maksimal periodik të lejuar për shpenzim dhe ndryshimit të tij gjatë vitit.
- Komunikim on-line dhe ulje e kostos operative të qarkullimit të dokumentacionit midis DPTH dhe Degeve të Thesarit.

- Sigurimi ne kohe reale i informacionit mbi angazhimet dhe shpenzimet efektive te agjensive shpenzuese si elemente te rendesishem ne planifikimin e flukseve dalese ditore/javore mujore te depozites se qeverise. Komunikim on-line me sistemin e 4 Ministrive kryesore qe mbajne peshen me te madhe te shpenzimeve te buxhetit.
- Centralizim i pagesave publike nepermjet llogarise unike te Thesarit ne Banken e Shqiperise; centralizimi i arketimeve publike ne llogarine unike te thesarit dhe mbyllja e llogarive te te ardhurave ne bankat e nivelit te dyte.
- Shtirirja graduale e perdorimit te titujve te te ardhurave publike: cdo arketim publik te shoqerohet me nje titull te gjeneruar me pare nga institucioni pergjegjes per mbledhjen e tij.
- Permirsimi i planifikimit te flukseve hyrese te depozites, nepermjet sigurimit on-line te informacionit tatimor dhe doganor per te ardhurat e parashikuara per t'u marre.
- Perfshirja e financimeve te huaja ne nje llogari te vetme te thesarit. Per kete: do te permiresohet mbulimi me te dhena i projekteve te financuara nga donatore te huaj; do te filloje menaxhimi aktiv i likuiditeteve ne llogarine unike te thesarit dhe ne llogarite speciale.

#### Menaxhimi i likuiditeteve dhe asetve financiare te Qeverise:

- Menaxhimi sipas standarteve i pjesemarrjes ne institucionet financiare kombetare dhe nderkombetare

### III.1.5 Fuqizimi i kontabilitetit, auditit te brendshem dhe sistemit te kontrollit te brendshem financiar publik ne te gjithë shtetin publik.

Politikat ne lidhje me funksionin e kontabilitetit publik synojne ne permiresimin e shpenzimeve publike dhe te menaxhimit te pasurive dhe ne rritjen e transparences fiskale. Kjo do arrihet nepermjet kontrollit paraprak (ex ante) te procedurave te kontabilitetit public dhe procedurave raportuese. Politikate kryesore do te jene:

*Pregatitja dhe zbatimi i Standarteve te Kontabilitetit dhe Formateve te Raportimit per ekzekutimin e buxhetit, per t'u perdorur nga strukturat e Thesarit dhe njesite shpenzuese;*

*Pershpejtimi i punes per adoptimin formal te formatit GFSM 2001 per kontabilitetin, perfshire dhe nxjerrjen e te dhenave qe dalin me frekuence te larte (flukset mujore te cash dhe te dhena tremujore per operacionet e qeverise), si dhe per te dhenat tremujore te borxhit publik jo financiar.*

Ne kuadrin e zhvillimit dhe zbatimit te infrastruktures IT bazuar ne programin Oracle, do te ndertohet dhe dokumentohet sa me shpejt te jete e mundur nje sistem kombetar llogarish per te gjithë nensektoret e qeverise, bazuar ne klasifikimet e GFSM 2001.

*Formulimi i ligjit te ri per "Per Kontabilitetin e sektorit publik" dhe sigurimi i standarteve kombetare te kontabilitetit publik bazuar ne standartet nderkombetare te kontabilitetit te ketij sektori sipas IPSAS.*

Politikat ne lidhje me kontrollin e brendshem synojne ne ngritjen e kuadrit te plote, ligjor dhe procedural per kontrollin e brendshem financiar publik, ne kuader reformimit dhe zhvillimit te financave publike. Keto perfshijne:

*Zhvillimi i mëtejshëm i Letrës së Politikave për KBFP dhe elementeve qe qendrojnë ne qender te ketij sistemi: pergjegjshmerise menaxheriale dhe auditimi i brendshem i decentralizuar dhe funksionalisht i pavarur.*

*Hartimi i politikave, programeve dhe strategjive per auditimin e brendshëm në sektorin publik.*

*Sigurimi i nje procesi me cilesi te lartë, transparencë dhe përgjegjshmëri te auditimit të brendshem në sektorin publik.*

*Hartimi i procedurave, metodologjive dhe udhëzimeve te pershtashme e të përditësuar , te cilat synojne mbështetjen e veprimtarise se audituesve te brendshëm me bazën e nevojshme teknike e proceduriale dhe pasqyrojne drejt e me ndershmeri zbatimin e standarteve ndërkombëtare te pranuar dhe direktivat e BE.*

*Ngritja e Njesise Qendrore te Harmonizimit, qe do te beje te mundur permiresimin e menaxhimit e kontrollit financiar ne te tere sektorin public.*

*Krijimi dhe zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore duke ofruar shërbime trainimi dhe edukimi te përditësuar për punonjësit e strukturave të auditimit të brendshëm.*

### III.1.6 Forcimi dhe institucionalizimi i marredhenieve fiskale nderqeveritare

*Rritja e transparences dhe objektivitetit ne percaktimin e alokimeve per pushtetin vendor. Procesi i buxhetimit vendor ka qene deri tani ad hoc. Mekanizmi i percaktimit te transfertave te kushtezuara dhe te pakushtezuara eshte ende i paparashikueshem dhe jo plotesisht transparent, duke qene shpesh rezultat diskutimesh dhe negociimesh (burokratike dhe politike) midis njesive te qeverise vendore dhe ministrive perkatese te linjes. Per kete, do te permiresohet me tej ekualizimi horizontal, per te reflektuar me mire dinamikat demografike dhe ekonomike te rajoneve te ndryshme te vendit, si dhe pabarazite midis tyre. Ne fushen e fondeve te kushtezuara, do te zgjerohet me tej procesi i alokimit te granteve konkurruese qe ka nisur ne 2006. Ky proces do te qartesohet me kritere dhe rregulla te sakta, me synim mbeshtetjen e projekteve te zhvillimit, me impakt ne zhvillimin social ekonomik rajonal. Kuadri i ri ligjor do te nise me ligjin mbi Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, pjesa e financave vendore dhe do te plotesohet me pas me ligjin e ri per Financat Vendore. Kuadri i ri rregullator do te institucionalizoje rolet respektive te pushtetit qendror dhe atij vendor, procesin e konsultimit lidhur me menaxhimin dhe monitorimin e financave vendore, formulimin e politikave fiskale dhe propozimet lidhur me reformen e decentralizimit ne kuader te PBA-se.*

*Permiresimi dhe qartesimi i kuadrit legjislativ per procesin e zbatimit te buxhetit vendor. Fushat kryesore te nderhyrjes se Ministrise se Financave do te jene: (i) procedurat e thesarit, kryesisht ato qe lidhen me diferencat e medha qe rezultojne midis sasise se parashikuar te grantit te kushtezuar nga njesite e qeverisjes vendore dhe sasise efektive; (ii) dalja ne kohen e duhur dhe qartesia e udhezimeve dhe detajeve nga Ministria e Financave ne lidhje me procesin e buxhetit; (iii) rregullat per zbatimin e buxhetit, ne lidhje me ekzistencen e nje llogarie unike te thesarit per te gjitha te ardhurat e pushtetit vendor dhe si pasoje me mundesine qe te kete zhvendosje dhe perdorim te ketyre burimeve ne kohe krizash likuiditeti; (iv) sistemi i raportimeve financiare dhe i kontabilitetit dhe veshtiresite qe lidhen me “ndjekjen” e shpenzimeve te buxheteve vendore dhe perdorimin e tyre ne perputhje me buxhetin e aprovuar*

*Permiresimi i kuadrit ligjor per taksat vendore, permes adoptimit te nje pakete fiskale vendore, e cila synon rritjen e autonomise fiskale te pushtetit vendor dhe thellimin e decentralizimit fiskal sipas funksioneve.*

*Zbatimi i nje kuadri fiskal te qendrueshem per huamarrjen vendore. Qeverite vendore ende nuk marrin hua, por po behen perpjekje serioze per draftimin e nje ligji mbi huamarrjen vendore. Per aprovimin dhe zbatimin e huamarrjes vendore, qeveria do te*

siguroje nje kuader politikash qe vendos rregulla te qarta mbi: (i) koordinimin e politikave per borxhin kombetar dhe vendor (ne menyre qe pushteti qendror te mbaje nen kontroll natyren dhe shtrirjen e detyrimeve financiare te pushtetit vendor); (ii) sigurimin e nje huamarrje vendore te kujdeshme (lidhur me menaxhimin e risqeve ne kuader te financave publike); (iii) sistemin e garancive vendore per huamarrjen; (iv) kufizimet ne volum te borxhit publik vendor, ngushtesisht te lidhura me menaxhimin e financave publike dhe borxhin publik total; (v) mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit; (vi) zgjidhjen e rasteve te veshtiresive financiare te pushtetit vendor qe rrjedhin nga huamarrja, per te shmangur qe per keto detyrime financiare te pergjigjet pushteti qendror (Ministria e Financave).

Tabela III.1 Politikat ne sherbim te permiresimit te menaxhimit te financave publike

Permiresimi I cilesise se shpenzimeve	Parashikimet makroekonomike dhe fiskale	Planifikimi dhe zbatimi I investimeve publike	Sistemi I menaxhimit te shpenzimeve e publike	Menaxhimi dhe kontrolli I thesarit	Kontabiliteti, auditimi i brendshem dhe sistemi i kontrollit te brendshem financiar public	Mardheniet fiskale nderqeveritare
2008-9	Hartimi I nje kuadri konsistence Vendorsja e mekanizmit te bashkepunimit me BoA	Zbatimi I planit te punes per permiresimin e menaxhimit te shpenzimeve publike Racionalizimi I investimeve te financuara nga fondet vendase Vleresim I Standartizuar Permiresimi I parashikimeve e per mirembajtjen	Fillimi I zbatimit te LOB Rishikimi dhe vleresimi I procedurave per transfertat Institucionalizimi I PBA-se. Forcimi I lidhjes ndermjet Buxhetit vjetor, PBA-se dhe SKZHI-se.	Perditesimi I plote I rregullores se thesarit Dizenjimi I sistemit te menaxhimit te thesarit Dizenjimi I sistemit te menaxhimit te marreveshjeve Fondet e donatoreve nepermjet llogarise se vetme te thesarit Komunikimi online ndermjet drejtorise se thesarit dhe zyrave te thesarit neper rrethe. Sigurimi ne kohe I informacionit per marreveshjet dhe shpenzimet. Centralizimi I transaksioneve ne nje Llogari te Vetme Thesari Perdorimi i titujve te ardhurave publike Parashikimet per cash	Formulimi I plote I LOB dhe rregullores se decentralizimit Standartet e Kontabilitetit dhe Formatet te Raportimit per ekzekutimin e buxhetit Harmonizimi I rekordeve fiskale dhe te kontabilitetit Zbatimi I sistemit te ri te kompiuterizuar te thesarit ne te gjitha e Shqiperise Ligji i ri per standartet e kontabilitetit publik Kuadri ligjor per kontrollin e brendshem financiar publik Zhvillimi i letres se politikave per KBFP Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe njerezore Hartimi i procedurave, metodologjive, udhezimeve	Rritja e transparences dhe objektivitetit ne percaktimin e alokimeve per pushtetin vendor. Permiresimi i kuadrit legjislativ/rregullues per procesin e zbatimit te buxhetit lokal Permiresimi I kuadrit legjislativ te taksave vendore Kuader fiskal i qendrueshem per huamarrjen vendore
2010-11	Operimi I plote I kuadrit te konsistences ndermjet Ministrise se Financave dhe Bankes se Shqiperise.	Zbatimi I planit te veprimeve per permiresimin e menaxhimit te investimeve publike. Integrimi I planifikimit te investimeve me PBA-ne Analizat kosto-perfitim per investimet	Institucionalizimi I PBA-se. Fuqizimi I tavaneve te PBA-se per vitet pasuese Fuqizimi I pergjegjshmerise ndaj Kuvendit	Zbatimi I sistemit te menaxhimit te thesarit Zbatimi I sistemit te marreveshjeve Financimet e huaja nepermjet llogarise se vetme te thesarit Komunikimi Online I te gjitha institucioneve buxhetore Adoptimi formal te formatit <i>GFSM 2001</i> per kontabilitetin	Zbatimi I plote i harmonizimit te rekordeve financiare dhe te kontabilitetit Sistem kombetar llogarish bazuar ne GFSM 2001. Zhvillimi i letres se politikave per KBFP Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe njerezore per auditimin e brendshem Hartimi i procedurave, metodologjive	Proces buxhetimi vendori vecuar, transparent dhe i besueshem.
2012-13		Aprovimi i financimit per koston e plote te projekteve shumevjecare te investimeve.	Zbatimi I vleres se plote te prokurimeve shumevjecare	Sistemi i menaxhimit te thesarit per te gjitha institucionet buxhetore ne Shqiperi.	Monitorimi I standarteve. Zgjerimi I aktivitetit te auditit tek fondet e BE-se.	Konsolidimi I financave vendore dhe I procesit te huamarrjes vendore.

## III.2 Zgjerimi i bazes tatimore dhe perputhja e politikave tatimore me perparësitë kombëtare

Per fuqizimin e politikave tatimore ndryshimet do te prekin tre fusha kryesore.

### III.2.1 Rritja e bazes se taksueshme dhe shperndarja e saj ne menyre me te drejte dhe me pak deformuese

Ne situaten aktuale te evazionit fiskal ne Shqiperi, zgjerimi i bazes tatimore ka te beje me shume me administrimin e taksave sesa me ndryshimet legjislative. Megjithate, politikat tatimore do te kontribuojne ne rritjen e pajtueshmerise se taksapaguesve me detyrimet e tyre ndaj shtetit dhe ne rritjen e kultures se taksave ne Shqiperi. Politikat kyce do te jene:

*Adoptimi i nje sistemi te rrafshet fiskal*, me norma te uleta taksash. Kjo perkthehet ne tatimin uniform te te ardhurave personale (duke filluar nga nje prag i caktuar) me nje shkalle te vetme prej 10% (qe nga mesi i vitit 2007 per tatimin mbi te ardhurat personale)), dhe pergjysmimin e normes se tatimit mbi fitimin nga 20% ne 10% qe ka filluar ta aplikohet ne 1 janar 2008. Kjo politike synon thjeshtimin e sistemit te administrimit te taksave dhe formalizimin e ekonomise. Qe nga viti 1994, 11 vende te Europes kane vendosur taksen e sheshte ne sistemet e tyre fiskale, ndersa tre vende te tjera pritet ta vendosin ate ne vitin 2008 (Shqiperia, per tatim fitimin, Republika Ceke dhe Bullgaria). Rezultatet jane te ndryshme dhe studimet ne kete fushe nuk kane dale ende ne nje perfundim te pranuar universalisht. Megjithate, vlen te permendet qe eksperiencia e disa prej ketyre vendeve ka treguar se vendosja e nje takse te sheshte me nje norme te ulet sherben per te nxitur nje numer institucionesh, individe dhe shoqeri tregtare, te dalin nga zona gri dhe informale e ekonomise, qe do te sillte dhe rritjen e te ardhurave tatimore. Nje nga perfundimet e pranuar nga studiuesit eshte se suksesi i nje regjimi takse te sheshte varet nga norma e taksës: sa me e ulet norma aq me eficente taksa e sheshte.

*Menaxhimi i pajtueshmerise fiskale.* Politikat do te fokusohen drejt identifikimit dhe reduktimit te burimeve kryesore te evazionit fiskal dhe uljes se hendekut midis taksave te mbledhshme ne baze te legjislacionit ekzistues dhe taksave qe efektivisht mblidhen. Miratimi dhe zbatimi gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2007 të ndryshimeve të rëndësishme fiskale, kryesisht aplikimit të taksës së sheshtë, u shoqërua me një "paketë" të dytë e cila konsistonte në eliminimin e të gjitha përjashtimeve dhe lehtësirave që ishin akorduar më parë si në tatimin mbi fitim ashtu edhe për TVSH, të cilat deformonin konkurrencën e lirë në treg. Politika e shfuqizimit dhe minimizimit te perjashtimeve nga taksat, eshte nje politike, e cila eshte ndjekur nga pothuajse te gjitha vendet te cilat kane aplikuar sistemin taksa e sheshte (flat tax). Kryesisht kjo "paketë" përjashtimesh konsiston në :

- Heqja e përjashtimit nga TVSH për OJF që kryenin furnizim mallrash a shërbimesh për trajtim mjeksor ose dentar, furnizim shërbimesh për mbrojtjen e kujdesin ndaj fëmijëve ose të moshuarve; per furnizim shërbimesh arsimore, kulturore a sportive; per furnizimin e shërbimeve arsimore nga institucionet arsimore publike dhe private, per pajisjet mjekësore; per periodiket dhe librat e çfaredo lloji ne furnizimet e importit.
- U reduktua njohja e shpenzimeve te zbritshme per efekt te tatim-fitimit, per te gjithë subjektet, persona fizike dhe juridike, te cilet paguajne tatim-fitimit, sipas ligjit per tatimin mbi te ardhurat, dhe te cilet kryejne sponsorizime per qellime te ndryshme. Njohja e mases se ketyre sponsorizimeve, eshte reduktuar nga 4% ne nivelin 3%, per subjektet tatimpagues te taim-fitimit dhe per sponsorizimet e realizuar posacerisht per

botuesit e shtypit, shuma e sponsorizimit të njohur, reduktohet nga 10% në 5% të të ardhurave të taueshme. Gjithashtu u shfuqizua dhe mosnjohja e shpenzimeve të zbritshme, për të gjithë subjektet, të cilët janë tatimpagues të taksave vendore mbi biznesin e vogël, të cilët kryejnë sponsorizime.

- U shfuqizua përjashtimi nga tatim-fitimi për personat e stimuluar në fushën e turizmit.

Heqja e këtyre përjashtimeve të dhëna me ligjet fiskale apo ligje të tjera të vecanta, të cilat do të kenë impaktin e vetë pozitiv në buxhetin e shtetit, duke siguruar të ardhura shtese jo vetëm nga eliminimi i tyre, por gjithashtu edhe nga permiresimet në administrimin e burimeve të tjera, të cilat linin shteg për abuzime.

*Reduktimi i transaksioneve të kryera në cash.* Në paketën fiskale të vitit 2007, një element i rëndësishëm i reformave të miratuara lidhet me kanalizimin e të gjitha transaksioneve financiare nëpërmjet sistemit bankar. Ndryshimet kanë të bëjnë me disiplinimin e transaksioneve financiare dhe monetare të cilat duhet që të kanalizohen nëpërmjet sistemit bankar, në mënyrë që të reduktohet sasia e “cash” në ekonomi. Gjithashtu, është detyrim ligjor tashmë që të gjitha subjektet punëmarrëse të kryejnë pagesat nëpërmjet sistemit bankar. Rrjeti i bankave të nivelit të dytë dhe rrjeti i shërbimit që ato ofrojnë, është zgjeruar ndjeshëm në të gjithë territorin e vendit dhe punonjësit e sektorit privat tashmë u ofrohet tërheqja e pagave nëpërmjet sistemit bankar. Këto reforma të sistemit fiskal jo vetëm që synojnë në formalizimin e ekonomisë shqiptare por gjithashtu ndihmojnë në luftën kundër informalizetit.

Duhet theksuar se taksat me të prekura nga evazioni fiskal në Shqipëri janë Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP) dhe Kontributet e Sigurimeve Shoqërore. Një burim tjetër i konsiderueshëm evazioni është edhe mosraportimi për efekt të regjistrimit me TVSH. Në këtë kuadër, disa nga ndryshimet në politikë që do të realizohen janë:

- Vendosja e deklaramit integral të të ardhurave. Deklarimi integral i të ardhurave personale do të përbejë faktor të rëndësishëm kyç për parandalimin e evazionit të tatimit mbi të ardhurat personale. Kjo sepse, në kushtet aktuale të mosraportimit real të pagave, kontrollet dhe inspektimet për mbajtjen në burim të TAP kanë shumë pak efekt në mbledhjen e të ardhurave shtese në krahasim me koston e tyre. Vendosja e deklaramit integral të të ardhurave personale do të ndikojë gjithashtu edhe në mbledhjen e disa taksave që aktualisht derdhen në sasi të paperfillshme në buxhetin e shtetit, siç është tatimi mbi të ardhurat nga qerata dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Vendimi që kjo politikë të jetë afatgjatë lidhet me vështiresitë dhe kufizimet serioze të administratës tatimore për të menaxhuar siç duhet kërkesat e deklaramit integral.
- Ulja e evazionit fiskal nga mosraportimi real i pagave për mbajtjen në burim të TAP, kjo do të arrihet përmes rritjes së kanalizimit bankar të pagave dhe vendosjes së pagave referuese. Me ndryshimet ligjore të vitit 2007, shpenzimet për paga të bizneseve nuk do të njihen si të zbritshme nëse pagesat nuk kalojnë nga sistemi bankar.
- Përmirësimet në sistemin e kontributeve të sigurimeve shoqërore do të rrisin numrin e kontribuesve në skemë.

*Thjeshtimi i akteve tatimore ligjore dhe nënligjore.* Ligjet tatimore shqiptare (në vecanti ai mbi procedurat tatimore dhe tatim fitimi) përmbajnë dispozita kontradiktore, nënë që mbivendosen, dhe boshllëqe që duhet të qartësohen. Kjo situatë i krijon mundësi punonjësve tatimore të ushtrojnë lirine e tyre në interpretimin e ligjeve, duke i hapur rrugë korrupsionit dhe duke ulur/dekurajuar shlyerjen vullnetare të detyrimeve. Për këtë arsye, ka filluar dhe do të vazhdojë rishikimi i të gjitha rregullave dhe procedurave, për harmonizimin e legjislacionit tatimor shqiptar. Në këtë kuadër, shumë i rëndësishëm është



rishikimi dhe amendimi i ligjit mbi procedurat tatimore dhe rishikimi dhe amendimi i procedurave të mbledhjes së tatimit fitimit.

Ne kuadrin e *transferimit të mbledhjes së taksës mbi biznesin e vogël tek administrata vendore*, si dhe të aplikimit të tatimit mbi të ardhurat personale prej 10% mbi biznesin e vogël (1 janar 2008) administratat tatimore qendrore dhe vendore do të bashkëpunojnë për mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave nga biznesi i vogël, me synim uljen e evazionit dhe permiresimin e kushteve konkurruese për bizneset. Problemet kryesore lidhen me identifikimin e subjekteve potenciale të TVSH-se, me aplikimin e njëtrajtshëm të legjislacionit tatimor, me krijimin e standarteve unike për percaktimin e bazës së taksueshme për taksën mbi biznesin e vogël, etj.

### III.2.2 Zhvillimi i nje sistemi taksash qe mbeshtet formulimin e politikave fiskale te drejta dhe nxitese per zhvillimin ekonomik dhe te biznesit.

*Permbushja e detyrimeve qe rrjedhin nga politika tregtare e Shqiperise.* Angazhimet në kuadrin e OBT-se dhe MTL-ve do të pasqyrohen në paketat fiskale të çdo viti. Keto janë :

- Zbatimi i Marrëveshjes Unike të Tregtisë së Lire, CEFTA, e Amenduar dhe Zgjeruar, që nga korriku i vitit 2007, që ka krijuar zonen rajonale të tregtisë së lire midis Shqipërisë, Kroacisë, Maqedonisë, Moldavisë dhe Unionit Serbi dhe Mali i Zi, si dhe UNMIK dhe Kosovës.
- Hyrja në fuqi dhe zbatimi i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Turqinë. Për palen shqiptare kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi në mars të 2007 dhe pritet konfirmimi i palës turke. .
- Zbatimi i skedulit të rishikuar, pa bërë asnjë derogim të mëtejshëm, në kuadrin e angazhimeve të marra me Organizatën Botërore të Tregtisë.
- Zbatimi i Marrëveshjes së Tregtisë së Lire me BE.

*Krijimi i klimes së përshtatshme për investimet:*

- Vlerësimi i impaktit të eliminimit të pengesave tarifore dhe jo tarifore në permiresimin e klimes së biznesit;
- Vendosja e taksës së sheshtë. Krahas avantazheve që u përmenden më lart në lidhje me zgjerimin e bazës së taksueshme, kjo politikë pritet të rrisë konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare nepermjet permiresimit të klimes së biznesit. Ndonese nuk është provuar një lidhje e drejtperdrejte midis vendosjes së taksës së sheshtë dhe ecurisë makroekonomike të një vendi, analizat e kryera mbi ekonomitë e një numri vendesh kanë treguar një tendencë pozitive të rritjes ekonomike pas vendosjes së taksës (për shembull rasti i Sllovakisë).
- Rishikimi i sistemit të taksave me fokus të veçantë shkurtimin e listës së taksave të aplikueshme në Shqipëri; kthimin e shumë prej tyre në tarifa shërbimi dhe transformimin e disa taksave nacionale në taksa vendore.

*Mbeshtetje për disa sektore jetike të ekonomisë shqiptare.* Në kuadër të politikës fiskale, në vëmendje ka qënë akordimi i lehtësive fiskale për dy sektorë të rëndësishëm: (i) enegjinë dhe (ii) bujqësinë. Në këtë kuadër, subjektet të cilët ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5MË për burim, përfitojnë rimbursimin e akcizës së paguar, të lëndës djegëse të përdorur. Gjithashtu, janë shfrytëzuar disa elementë të mekanizmit të tatimit mbi vlerën e shtuar, me qëllim të ndikimit të tyre në një fushë sic është ajo e sistemit agrar. Nga 1 janar 2008, fermerët të përfitojnë një kompensim (6%) për të mbuluar pjesërisht një pjesë të TVSH-së së paguar më parë prej tyre e përfshirë në çmimin e blerjes së mallrave e shërbimeve, që atyre u janë furnizuar për nevoja të veprimtarisë së tyre ekonomike. Në parim, këto blerje në

pjesën të konsiderueshme, nuk kryhen për nevoja të konsumit final, por për t'u ricikluar në një zinxhir ekonomik. Sipas skemes së kompensimit, fermerët shqiptarë që kryejnë veprimtari individuale apo familjare, për produktet e shitura në të tretë të përfitojnë një kompensim të akorduar përkundrajt shitjeve të bëra prej tyre për llogari të personave të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së.

### III.2.3 Perafrimi i politikave për taksat me *Acquis Communautaire*

*Perafrimi i legjislacionit për taksat direkte dhe indirekte* me legjislacionin e Bashkimit Europian, sipas rekomandimeve të BE-se. Në aneksin 1 të Planit të zbatimit të Marreveshjes së Stabilizimit Asocimit, pika 3.11 rendit iniciativat ligjore që duhet të ndermerren për të përafuar legjislacionin tatimor shqiptar me Acquis. Disa nga keto ndryshime ligjore përfshijnë: harmonizimi i tarifave të akcizes me ato të BE-se (dhjetor 2010); zgjerimi i sistemit integral të deklarimit dhe pagimit të tatimit mbi të ardhurat personale (dhjetor 2008); aplikimi i sistemit të plate integral për deklarimin dhe pagimin e të ardhurave (dhjetor 2010).

*Reduktimi gradual dhe eliminimi i barrierave tregtare tarifore me vendet e BE-se.*

**Tabela III.2** Politikat në shërbim të zgjerimit të bazës tatimore dhe përmirësimit të politikave tatimore

Zgjerimi i bazës së taksueshme dhe përputhja e politikave tatimore me prioritetet kombëtare	Rritja e bazës së taksueshme dhe shpërndarja e saj në mënyrë me të drejtë dhe me pak deformuese	Zhvillimi i një sistemi taksash që mbështet formulimin e politikave fiskale të drejta dhe nxitese për zhvillimin ekonomik dhe të biznesit.	Perafrimi i politikave për taksat me legjislacionin Europian
2008-2009	Menaxhimi i hendekut të shlyerjes vullnetare të detyrimeve Zgjidhja e problemeve të mbivendosjeve administrative midis administratës vendore dhe asaj qendrore për mbledhjen e tatimit mbi biznesin e vogël. Zbatimi i sistemit të takses së sheshtë	Përbushja e detyrimeve që rrjedhin nga politika tregtare <ul style="list-style-type: none"> <li>• CEFTA</li> <li>• MTL me Turqinë</li> <li>• Skeduli i angazhimeve të OBT-se</li> </ul> Krijimi i klimes së përshtatshme për investime: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i impaktit të eliminimit të pengesave tarifore dhe jo tarifore</li> <li>• Racionalizimi i numrit dhe llojeve të taksave</li> </ul>	Perafrimi i legjislacionit për taksat indirekte dhe direkte Reduktimi gradual dhe eliminimi i barrierave tregtare me vendet e BE-se.
2010-2011	Menaxhimi i hendekut të shlyerjes vullnetare të detyrimeve Zbatimi i sistemit të takses së sheshtë	Përbushja e detyrimeve që rrjedhin nga politika tregtare Respektimi i skedulit të angazhimeve të OBT-se.	Reduktimi gradual dhe eliminimi i barrierave tregtare me vendet e BE-se. Perafrimi i legjislacionit për taksat indirekte dhe direkte
2012-2013	Zbatimi i sistemit të takses së sheshtë	Përbushja e detyrimeve që rrjedhin nga politika tregtare	

### III.3 Modernizimi i menaxhimit të borxhit publik

Ky komponent i strategjisë ka të bëjë me menaxhimin e huamarrjes së qeverisë për plotësimin e nevojave për financim të saj, në mënyrë të tillë që të ulen kostot dhe risqet e borxhit publik në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Elementet kyç të këtij komponenti janë:

### III.3.1 Menaxhimi i risqeve të huamarrjes së brendshme dhe ulja e kostos së saj

Politikat do të synojnë zgjatjen e periudhës së maturimit të borxhit të brendshëm dhe rritjen e peshës specifike të borxhit afatgjatë ndaj totalit të borxhit të brendshëm, përmes:

*Zhvillimi i tregut të brendshëm të letrave me vlerë.* Do të ndermerren hapa në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë së tregut të letrave me vlerë të qeverisë, siç janë zgjerimi i ankandëve të bonove të thesarit, zhvillimi i një tregu dytesor efektiv dhe likuid për letrat me vlerë të qeverisë. Këto masa do të sigurojnë pjesëmarrje më të gjera të individëve dhe investitorëve individuale në financimin e borxhit të qeverisë.

*Diversifikimi i instrumentave të financimit.* Emetimi i obligacioneve qeveritare pesë dhe shtatë-vjeçare në leke dhe në monedhë të huaj; zgjerimi i instrumentave afatgjatë të huamarrjes, përfshirë ato 7 vjeçar të emetuara në fund të vitit 2007.

*Forcimi i menaxhimit strategjik të borxhit.* Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare Afatmesme të Borxhit 2008-2010.

### III.3.2 Krijimi i një strukture më të mirë ndërmjet borxhit të jashtëm dhe atij të brendshëm dhe ulja e raportit borxh i brendshëm/PBB

Politikat do të fokusohen në reduktimin e borxhit të brendshëm<sup>4</sup> dhe në rritjen e peshës së borxhit të jashtëm. Pakesimi së fundmi i stokut të borxhit të brendshëm, ardhur si rezultat i rënies së deficitit, pritet që të vazhdojë në të ardhmen e afert, por politikat do të mbështesin rënien në periudhë me afat gjatë nepermjet:

*Reduktimi i mbështetjes në burimet e brendshme* për të financuar deficitin, për shkak të kostos së lartë të interesave të stokut të borxhit të brendshëm.

*Perdorimi i fitimeve në të ardhura nga administrim i taksave për pakesimin e borxhit të brendshëm;* *Perdorimi i një pjese të të ardhurave nga privatizimi* për të reduktuar stokun e borxhit të brendshëm.

*Rritja graduale e aksesit në burimet e financimit tregtare afatgjatë në tregjet e huaja të kapitalit,* në mënyrë që të rritet fleksibiliteti në financimin e jashtëm të borxhit publik. Kushte për këtë do të jenë: përmirësimi i performancës makroekonomike; krijimi i një eksperience të shëndoshe në lidhje me dokumentimin dhe pagesat e detyrimeve debitorë (duke përfshirë shlyerjen e borxhit të prapambetur); dhe përmirësimi i treguesve të kreditimit në tregjet ndërkombëtare.

*Reduktimi i stokut të borxhit të brendshëm do të jetë pjesë integrale e Strategjisë Afatmesme të Borxhit 2008-2010.*

### III.3.3 Krijimi i një sistemi të integruar për menaxhimin të borxhit.

*Fuqizimi i Drejtorisë së Menaxhimit të Borxhit,* nepermjet ngritjes së kapaciteteve njerezore dhe sistemit të rregjistrimit dhe menaxhimit të borxhit

<sup>4</sup> Vlerësimet empirike tregojnë se një rritje me një pike prej 1% të PBB-së në financimin e brendshëm redukton rritjen e PBB-së për frymë me një të tretën e një pike përqindjeje (Baldacci, 2003). Studimet tregojnë gjithashtu se rregullimet fiskale të bazuara në reduktimin e financimeve të brendshme kanë rreth një here e gjysëm efekt mbi rritjen sesa rregullimet e bazuara mbi të dy burimet e financimit, të brendshëm apo të jashtëm (Gupta, 2002).

*Implementimi i sistemit te integruar te menaxhimit te borxhit***Tabela III.3 Politikat ne sherbim te modernizimit te menaxhimit te borxhit publik**

Modernizimi menaxhimit te borxhit	Menaxhimi i risqeve te huamarrjes se brendshme dhe ulja e kosos se saj	Krijimi i nje strukture me te mire borxh i jashtem / borxh i brendeshem dhe reduktimi i raportit te stokut te borxhit te brendshem ndaj PBB	Krijimi i nje sistemi te integruar per menaxhimin e borxhit.
2008-2009	Diversifikimi i instrumentave te financimit. Fuqizimi I menaxhimit strategjik te borxhit.	Reduktimi i mbeshtetjes ne burimet e brendeshme per financimin e deficitit. Rritja e aksesit ne financimet zyrtare te huaja Perdorimi i te ardhurave shtese nga administrimi i taksave dhe i te ardhurave nga privatizimi per reduktimin e borxhit te brendshem. Berja e reduktimit te stokut te borxhit nje pjese integrale e strategjise afatmesme te borxhit.	Fuqizimi i Drejtorise se Menaxhimit te Borxhit nepermjet ngritjes se kapaciteteve njerezore dhe sistemit te rregjistrimit dhe menaxhimit te borxhit
2010-2011	Zhvillimi I tregut te brendeshem per obligacionet e qeverise Fuqizimi I menaxhimit strategjik te borxhit.	Reduktimi i mbeshtetjes ne burimet e brendeshme per financimin e deficitit. Rritja e aksesit ne financimet zyrtare te huaja Perdorimi I te ardhurave nga privatizimi per te reduktuar stokun e borxhit.	Implementimi i sistemit te integruar te menaxhimit te borxhit
2012-2013	Zhvillimi I tregut te brendeshem per obligacionet e qeverise	Shqiperia ka akses ne burimet e financimit tregtare te jashtem afatgjate	

**III.4 Forcimi i performances dhe besueshmerise se administratave tatimore dhe doganore.**

Politikat per kete shtylle te strategjise jane:

**III.4.1 Perqendrimi i perpjekjeve te administrates ne burimet kryesore te evazionit fiskal dhe reduktimi i hendekut midis taksave te mbledhshme sipas legjislacionit tatimor dhe atyre qe mblidhen efektivisht.**

Administrata tatimore:

*Forcimi i menaxhimit te pajtueshmerise me taksat.* Pajtueshmeria me taksat perkthehet ne shlyerjen vullnetare te detyrimeve ndaj shtetit te individeve dhe bizneseve. Fokusi i punës së Drejtorisë së Pergjithshme e Tatimeve do të jetë menaxhimi i pajtueshmerise me taksat. Realizimi i këtij objektivi pune do te kerkoje: monitorim nga afer te nivelit te pajtueshmerise te taksapaguesve me detyrimet e tyre fiskale ne lidhje me regjistrimin, deklarimin, pagesen, mos raportimin dhe menytrat e tjera te evazionit fiskal. Vemendja do te perqendrohet ne:

- Permiresimi i administrimit te tatimit mbi te ardhurat personale dhe kontributeve te sigurimeve shoqerore. Ne periudhen afatshkurter dhe afatmesme politikat do te perqendrohen ne: thjeshtimin e procedurave per deklarimin dhe mbajtjen ne burim te TAP dhe kontributeve; intensifikimin e kontroleve mbi detyrimet e deklarimeve dhe pagesave, dhe auditimet e perbashketa per te dyja taksat, ne menyre qe te shfrytezohen ekonomite e shkalles dhe te rriten te ardhurat, si pasoje e kombinimit te dy funksioneve. Ne periudhen afatgjate do te vendoset deklarimi integral i te ardhurave, i shoqeruar nga nje program per rritjen e pajtueshmerise se individeve me detyrimet tatimore, bazuar ne kontrole efektive mbi deklarimin dhe pagesen, ne procese auditimi efektive dhe administrim eficient te pagesave te pashlyera.
- Permiresimi i administrimit te TVSH-se dhe rritja e pajtueshmerise me kete takse permes forcimit te kontroleve mbi zbatimin dhe pagesen e TVSH-se dhe administrimit te problemeve te mosraportimit. Nje element kyc i administrimit te kesaj takse eshte rimbursimi, qe ka efekte te rendesishme mbi pajtueshmerine dhe pagesen e saj nga taksapaguesi. Per kete, planet strategjike te DPT dhe menaxhimi i performances do te kene si objektiv zbatimin e plote te detyrimeve per TVSH-ne e parimbursuar dhe identifikimin dhe zbatimin e metodave te punes per te siguruar rimbursimin ne kohe te kesaj takse.
- Thjeshtimi i procedurave te pageses se taksave. Ne periudhen afatshkurter do te vendoset shlyerja e detyrimeve tatimore nepermjet internetit per taksapaguesit e medhenj, mbeshtetur ne monitorimin e zhvillimeve qe ka perdorimi i internetit nga ana e biznesit, duke balancuar kostot dhe perfitimet; do te zgjerohet perpunimi i informatizuar i deklaratave tatimore, dhe shkembimi i informacionit me tatimpaguesit (e-taxation).
- Permiresimi i regjistrimit dhe mbledhjes se taksave, per parandalimin e shkeljeve te legjislacionit tatimor.

#### Administrata doganore

*Zhvillimi dhe permiresimi i metodave per mbledhjen, analizen dhe shfrytezimin e informacionit doganor.* Ky informacion do te perdoret efektivisht per parandalimin e shkeljeve te legjislacionit doganor, dhe per zbulimin e fajtove.

*Zhvillimi i shkembimit te informacionit dhe rritja e bashkepunimit mes doganave shqiptare dhe sektorit te biznesit, institucioneve te tjera shqiptare dhe doganave te vendeve te tjera, institucioneve europiane dhe organizatave nderkombetare, ne fushen e zbatimit te legjislacionit doganor, parandalimit te shkeljeve, kontrollit dhe hetimit.*

### III.4.2 Rritja e cilesise se sherbimit ndaj taksapaguesve.

#### Administrata tatimore

*Forcimi i sherbimit ndaj taksapaguesve,* nepermjet fuqizimit te stafit dhe administrimit te duhur te ketij funksioni ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve, me fokus te veçantë në zonat ku është përqëndruar numri më i madh i tatimpaguesve; do të përmirësohet funksionimi i zyrës së tatimpaguesve të mëdhenj, duke u shndërruar në një zyrë shërbimi për të gjithë; do të ristrukturohet ndarja territoriale e administratës, nepermjet krijimit të drejtorive rajonale me funksione të plota bazë dhe krijimit te qendrave të sherbimit të tatimpaguesve në zonat ku numri i tyre është i ulët

*Promovimi i nje kulture sherbimi brenda administrates tatimore.* Ky eshte nje objektiv me afatgjate, qe synon rritjen e shlyerjes vullnetare te detyrimeve nga taksapaguesit dhe rritjen e te ardhurave. Kjo do te arrihet permes:

- Vendosjes se objektivave te qarte dhe specifik ne lidhje me sherbimet per taksapaguesit dhe percaktimi i indikatorëve per matjen e performances ne arritjen e objektivave.
- Zhvillimi dhe shperndarja e programeve edukative dhe te informimit per taksapaguesit.

*Permiresimi dhe thjeshtimi i sistemit apelues, per te garantuar mbrojtjen e tatimpaguesit ne dy nivele: nje instance apeluese e ngritur brenda administrates tatimore, dhe nje tjetër e pavarur nga ekzekutivi, qe do te ngrihet ne formen e nje Gjykate Tatimore, si shkalle e fundit e ankimit administrativ.*

#### Administrata doganore

*Krijimi i kushteve te favorshme per zhvillimin e biznesit.*

*Furnizimi i publikut me informacione te plota dhe te qarta mbi aktivitetet e Doganes, dhe kuadrin perkates legjislativ dhe procedural.*

*Zbatimi i Dispozitave Zbatuese te Kodit Doganor Komunitar, aty ku ofrojne lehtesi qe ju aplikohen bizneseve.*

*Marrja e masave per zbatimin e iniciatives "e-Doganat" (Dogana Elektronike), qe do te realizoje: thjeshtimin e paraqitjes se deklarave doganore; kompjuterizimin e procedurave doganore; sigurimin me te lehte te informacionit; ofrimin e sherbimeve doganore te bazuara ne metoden "dritare e vetme"; perhapjen e gjere te informacionit mbi doganat ne publik.*

### III.4.3 Mbrojtja e tregjeve dhe shoqerise

Behet fjale per nje nga misionet e administrates doganore. Politikat e ndjekura nga kjo e fundit per arritjen e ketij objektivi strategjik do te jene:

*Zbatimi i masave per ruajtjen e sigurise se tregtise nderkombetare dhe per parandalimin e akteve terroriste dhe krimet te organizuar.*

*Persosja e sistemit te kompjuterizuar te metodikes se kontrolleve, bazuar ne menaxhimin e riskut, shkembimin e informacionit on-line me strukturat nderkombetare te specializuara.*

*Doganat do te luajne rolin e nje institucioni koordinues, pergjegjes per kontrollin e mallrave qe kalojne permes kufijve te jashtem te Shqiperise, ne kuadrin e Sistemit te Integruar te Mbrojtjes se Kufijve te Republikës se Shqiperise. Kontrolli i levizjes se mallrave do te realizohet me metodologjite moderne te perdorura ne vendet e BE-se, per ekzaminimin e mallrave dhe te mjeteve transportuese.*

Per kryerjen e funksionit te saj mbrojtës, Dogana do te pajiset me mjete kontrolli dhe aparatura per inspektim moderne dhe stafi do te trajnohet per perdorimin me eficence te tyre.

### III.4.4 Rritja e performances, forcimi i kontrollit mbi menaxhimin dhe i auditimit te brendshem

#### Administrata tatimore

Politikat ne kete fushe kane per qellim permiresimin e situates ne lidhje me zbatimin jo te rregullt te procedurave, mungesen e menaxhimit bazuar ne risk, mungesen e efektivitetit te auditimit, mungesat ne trajnime te punonjesve, etj.

*Permiresimi i kapaciteteve per menaxhim strategjik.* Kjo do te siguroje qe DPT-ja te vleresoje dhe te reagoje ndaj zhvillimeve dhe ndryshimeve te brendshme dhe te jashtme, te identifikojte rreziqet me te medha qe mund te paraqiten ne lidhje me te ardhurat, te vendose menyra matje te performances se punonjesve dhe te menaxhoje aktivitetet ne baze te prioriteteve te vendosura ne planet strategjike. Kjo do te shmange perdorimin e praktikave te zbatimit te masave qe nuk jane te bazuara ne analiza dhe objektiva strategjike.

*Rritja e njohurive te stafit mbi procedurat,* qe punonjesit te kuptojne ne menyre te drejte dhe te zbatojne me korrektesi detyrat e tyre dite pas dite, sipas strukturave funksionale dhe manualeve te procedurave.

*Permiresimi i procedurave dhe sistemeve te auditimit te taksapaguesve.* Do te vendoset nje sistem auditimi qe seleksionon ne baze te riskut, mbeshtetur nga nje soft per vleresimin e riskut, qe do te siguroje seleksionimin e taksapaguesve mbi bazen e kritereve objektive. Skema e auditimeve do te kaloje nga nje skeme gjithepershireshe sic eshte aktualisht, ne nje me te ngushte, ose te fokusuar ne ceshtje te vecanta. Do te ndalohe praktikave te procedurave te auditimeve te detyrueshme. Do te zhvillohen trajnime ne mbeshtetje te vendosjes se teknikave moderne te auditimit.

*Rishikimi i eficences/efektivitetit te perdorimit te burimeve ne administraten tatimore.* Disa nga fushat e nderhyrjes jane:

- Rishqyrtimi i rolit te Policise Tatimore. Burimet njerezore aktuale te ketij organizmi do te integrohen ne strukturat funksionale te administrates, drejt aktiviteve me prodhimtari te larte per mbledhjen e te ardhurave (sic jane auditimi, mbledhja me force, investigimi, etj.), dhe qe ndihmojne ne rritjen e shlyerjes vullnetare te detyrimeve.
- Krijimi i degeve te medha rajonale (14-15), qe do te perfshijne deget e vogla tatimore aktuale (aktualisht 37 ne te gjitha Shqiperine); transformimi i degeve aktuale rajonale ne zyra sherbimi tatimor.
- Orientimi i burimeve drejt taksapaguesve te medhenj; permiresimi i strukturave te degeve te taksapaguesve te medhenj, marrja e masave per forcimin e kontrollit mbi shlyerjen e detyrimeve.

*Forcimi i punes se njesise Anti-Korrupsion te ngritur brenda administrates tatimore,* per luftimin e korrupsionit, mashtrimit dhe vjedhjeve; rishikimi i Kodit te Etikes; ngritja e sherbimit te standarteve profesionale dhe morale.

*Forcimi i procedurave te brendshme te auditimit,* nepermjet kryerjes se hetimeve mbi parregullsite ne pune, zbatimit te procedurave te ankimimit. Ne te njejten kohe, thjeshtimi dhe qartesimi i procedurave dhe rregullave do te parandaloje vendimet diskrecionale te punonjesve gjate zbatimit te detyrave te tyre.

*Forcimi i menaxhimit te burimeve njerezore.* Vendosja e rregullave transparente per rekrutimin, ngritjen ne detyre dhe shkarkimin e punonjesve, ne perputhje me rregullat baze te sherbimit publik dhe ligjit per Procedurat Tatimore; perfshirja graduale e punonjesve tatimore ne sherbimin publik; intensifikimi i trajnimeve, sidomos ne fushen e auditimeve, dhe arritja e respektimit te plote te legjislacionit dhe rregulloreve qe kane te bejne me procedurat dhe ceshtjet e burimeve njerezore.

*Kompletimi i informatizimit të administratës tatimore, përfshirja në SIT (Sistemi i Informatizuar i Taksave) i të gjitha llojeve të taksave<sup>5</sup>; komunikimi on-line me degët rajonale tatimore.*

#### Administrata doganore

Politikat në këtë fushë kanë për qëllim përmirësimin organizativ, zhvillimin e burimeve njerezore dhe investimet në teknologji.

*Modernizimi i menaxhimit të Doganës Shqiptare, duke patur në konsideratë praktikën me të mira ndërkombëtare, duke përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm dhe duke vendosur metoda të përditësuara të menaxhimit të cilësive.*

*Krijimi dhe zbatimi i koncepteve të centralizimit dhe decentralizimit për shpërndarjen e funksioneve dhe detyrave të kontrollit midis zyrave doganore.*

*Menaxhimi korrekt dhe i standartizuar i metodikave të vlerësimit doganor në të gjithë territorin doganor shqiptar.*

*Përmirësimi i kapaciteteve administrative të Doganës, duke krijuar kushtet e nevojshme për: terheqjen, specializimin dhe mbajtjen në punë të specialisteve të kualifikuar; vendosjen e një sistemi karrierash gradual; rritjen e motivimit të punonjësve; rritjen e kualifikimit të tyre. Vendosja e rregullave transparente për rekrutimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e punonjësve, në përputhje me rregullat baze të shërbimit publik dhe të Legjislacionit doganor, si dhe përfshirja graduale e tyre në shërbimin civil.*

*Parandalimi sistematik i rasteve të korrupsionit, zbulimi dhe hetimi me efektivitet të rasteve korruptive, zbatimi korrekt i ligjit mbi Konfliktin e Interesave, nepermjet zbatimit të standarteve për identifikimin, regjistrimin, zgjidhjen dhe denimin e rasteve konfliktuale; zhvillimi i standarteve të sjelljes anti korruptive.*

*Përqendrimi i aktiviteteve të Doganës Shqiptare në pikat më moderne dhe më mirë të pajisura.*

### III.4.5 Përsheptimi i progresit në lidhje me reformat për plotësimin e kërkesave të BE-se

Procesi do të përqendrohet në:

#### Administrata tatimore

*Rritja e kapaciteteve administrative për luftën kundër korrupsionit dhe evazionit fiskal.*

*Adoptimi i Kodit të Sjelljes për Taksimin e Biznesit; zbatimi i tij në lidhje me çdo masë të re fiskale.*

*Kompletimi i kompjuterizimit të zyrave tatimore, përmes krijimit të një sistemi të centralizuar për të gjitha shërbimet që lidhen me të ardhurat tatimore; zbatimi i deklaratave elektronike; përmirësimin në infrastrukture.*

*Rritja e transparencës dhe shkëmbimit të informacionit me vendet e BE-se.*

#### Administrata doganore

*Përafrimi i standarteve doganore me ato të BE-se.*

---

<sup>5</sup> Krijimi i Sistemit të Informatizuar të Taksave do të financohet nga Bashkimi Europian.



- Rritja e cilesise se sherbimit dhe shpejtesise se procedurave doganore;
- Rritja e komjuterizimit te procedurave doganore, vertikalisht dhe horizontalisht; shtrirja e sistemit te ASYCUDA ne te gjitha pikat doganore;
- Zbatimi i analizes se riskut ne te gjitha deget me fluks te larte dhe te mesem mallrash; permiresimi i perdorimit te modulit te riskut te sistemit ASYCUDA;
- Zbatimi i sistemit te automatizuar ASYCUDA WORLD, me anen e te cilit thjeshtohet paraqitja ne dogane e deklaratave dhe lehtesohet sigurimi dhe thjeshtimi i informacionit.

*Trajnimi i stafit per zbatimin e ligjeve dhe procedurave te perafuara me Acquis.*

*Forcimi i bashkepunimit administrativ me vendet qe kane nenshkruar MSA dhe vendet e BE-se.*

*Forcimi i luftes kunder evazionit fiskal, korrupsionit dhe kontrabandes, nepermjet forcimit te kapaciteteve administrative dhe te burimeve njerezore, dhe rritjes se bashkepunimit dhe shkembimit te informacionit me institucionet e BE-se, per parandalimin e evazionit dhe kontrabandes.*

*Perafrimi i legjislacionit dhe dispozitave doganore me Acquis, sipas pikes 3.12 te Aneksit 1 te Planit per zbatimin e MSA-se.*

Tabela III.4 Politikat ne sherbim te permiresimit te performances ne administraten tatimore

Forcimi i performances dhe besueshmerise se administratave tatimore dhe doganore.	Perqendrimi i perpjekjeve ne burimet kryesore te evazionit fiskal dhe reduktimi i hendekut tatimor.	Rritja e cilesise se sherbimit ndaj taksapaguesve.	Rritja e performances, forcimi i kontrollit mbi menaxhimin dhe auditimit	Pershpejtimi i progresit ne lidhje me reformat per plotesimin e kerkesave te BE-se
2008-9	<p>Permiresimi i mbledhjes se PIT dhe kontributeve shoqerore</p> <p>Permiresimi i administrimit dhe shlyerjes se tvsh</p> <p>Thjeshtimi i procedurave te regjistrimit dhe pageses</p>	<p>Forcimi i sherbimeve ndaj taksapaguesve</p> <p>Permiresimi i aksesit ndaj sherbimeve</p> <p>Mbrojtja e taksapaguesve ne dy nivele</p>	<p>Rritja e njohurive te stafit ne lidhje me procedurat</p> <p>Permiresimi i sistemit dhe procedurave te kontrollit te taksapaguesve</p> <p>Zbatimi i procedurave te auditimit te brendshem</p> <p>Rishikimi i eficences/efektivitetit te perdorimit te burimeve</p> <p>Kompletimi i infomatizimit te administrates (SIT)</p> <p>Forcimi i menaxhimit te burimeve njerezore</p>	<p>Krijimi i strukturave anti korrupsion brenda administrates tatimore</p> <p>Rritja e transparences dhe shkembimit te informacionit me vendet e BE-se</p> <p>Kompletimi i kompjuterizimit te zyrave tatimore</p> <p>Adoptimi i Kodit te Sjelljes per Taksimin e Biznesit</p>
2010-11	<p>Forcimi i menaxhimit te shlyerjes vullnetare</p> <p>Permiresimi i mbledhjes se PIT dhe kontributeve shoqerore</p>	<p>Promovimi i kultures se sherbimit me te mire ne administrate</p> <p>Zhvillimi dhe shperndarja e programeve edukative dhe informuese</p>	<p>Permiresimi i kapaciteteve per menaxhim strategjik</p> <p>Perdorimi me eficence/efektivitet i burimeve</p> <p>Zbatimi i procedurave te auditimit te brendshem</p> <p>Forcimi i menaxhimit te burimeve njerezore</p>	<p>Zbatimi korrekt i ligjeve dhe i rregulloreve</p> <p>Rritja e transparences dhe shkembimit te informacionit me vendet e BE-se</p>
2012-13	<p>Pagesa on line te detyrimeve tatimore</p>	<p>Promovimi i kultures se sherbimit</p> <p>Objektiva specifike dhe indikatore ne lidhje me sherbimin ndaj taksapaguesit</p>	<p>Permiresimi i kapaciteteve per menaxhim strategjik</p> <p>Forcimi i menaxhimit te burimeve njerezore</p>	<p>Rritja e transparences dhe shkembimit te informacionit me vendet e BE-se</p> <p>Intensifikimi i luftes kunder korrupsionit</p>

Tabela III.5 Politikat ne sherbim te permiresimit te performances ne administraten doganore

Forcimi i performances dhe besueshmerise se administratave tatimore dhe doganore.	Perqendrimi i perpjekjeve ne burimet kryesore te evazionit fiskal dhe reduktimi i hendekut tatimor.	Rritja e cilesise se sherbimit ndaj taksapaguesve.	Rritja e performances, forcimi i kontrollit mbi menaxhimin dhe auditimit	Pershpejtimi i progresit ne lidhje me reformat per plotesimin e kerkesave te BE-se	Mbrojtja e tregjeve dhe shoqerise
2008-9	Zhvillimi dhe permiresimi i menyrave per mbledhjen, analizen dhe shfrytezimin e informacionit doganor Zhvillimi i shkembimit te informacionit Permiresimi i regjistrimit dhe mbledhjes se taksave	Krijimi i kushteve te favorshme per zhvillimin e biznesit Zbatimi i dispozitave te legjislacioneve doganor europian Ofrimi i lehtesirave te parashikuara nga leghjislacioni doganor BE	Modernizimi i menaxhimit te doganave shqiptare Krijimi dhe zbatimi i koncepteve te centralizimit dhe decentralizimit Permiresimi i kapaciteteve administrative te doganave shqiptare Parandalimi sistematik i rasteve te korrupsionit Perqendrimi i aktiviteteve	Rritja e cilesise se sherbimit dhe shpejtesise se procedurave Rritja e kompjuterizimit te procedurave doganore Zbatimi i analizese se riskut Trajnimi i stafit ne zbatimin e ligjeve dhe procedurave te perafuara me Acquis Forcimi i bashkepunimit administrativ Forcimi i luftes kunder evazionit fiskal, dhe kontrabandes	Zbatimi i masave per ruajtjen e sigurise se tregtise nderkombetare Zbatimi i nje sistemi te kompjuterizuar menaxhimi te riskut per mallrat, procedurat doganore dhe njerezit Doganat do te luajne rolin e nje institucioni koordinues ne kuadrin e sistemit te integruar te mbrojtjes se kufijve
2010-11		Marrja e masave per zbatimin e iniciatives "e-Doganat" (dogana elektronike)	Modernizimi i menaxhimit te doganave shqiptare Parandalimi sistematik i rasteve te korrupsionit Krijimi dhe zbatimi i koncepteve te centralizimit dhe decentralizimit	Rritja e cilesise se sherbimit dhe shpejtesise se procedurave Zbatimi i analizese se riskut Trajnimi i stafit per Acquis Forcimi i bashkepunimit administrativ Forcimi i luftes kunder evazionit fiskal, korrupsioni dhe kontrabandes	
2012-13		Zbatimi i iniciatives "e-Doganat" (dogana elektronike)	Modernizimi i menaxhimit te doganave Parandalimi sistematik i korrupsionit	Forcimi i bashkepunimit administrativ me vendet pjese e MSA dhe vendet e BE-se	

## IV RRJEDHOJAT PER BURIMET

Ky kapitull paraqet ceshtjet kryesore financiare qe lidhen me arritjen e qellimeve te Strategjise. Ai jep nje veshtrim te pergjithshem mbi alokimet e burimeve midis fushave te ndryshme te politikave sipas parashikimeve te PBA-se 2008-2010, vlereson burimet e brendshme per vitet 2011, 2012 dhe 2013 sipas programeve buxhetore te Ministrise se Financave, si dhe identifikon flukset kryesore te financimeve te huaja qe aktualisht i shkojne sektorit te Financave Publike. Me pas, identifikohen ato fusha te strategjise zbatimi i te cilave kerkon investime te reja dhe ngritjen e kompetencave organizative.

Bazuar mbi parashikimin e perafert te burimeve per Ministrine e Financave, supozohet qe cdo kosto shtese do te perballohet me nje nga keto tre menyra: burime te reja (te brendshme apo te huaja); rialokim te burimeve ekzistuese nga fusha me vlere te ulet strategjike ne ato me vlere te larte strategjike; permiresim i menaxhimit te burimeve. Analiza e rrjedhojave per burime qe behet ne kete kapitull nuk e eshte e plote dhe ka nevojte per: informacion dhe analiza me te plota per kostot korente duke u nisur nga ato ekzistuese; rezulatet e procesit te vendosjes se prioriteve nga SKZHI, pjese e te ciles eshte dhe kjo strategji; informacion mbi marreveshjet e ardhshme me donatoret per mbeshtetjen qe keta do t'i japin realizimit te strategjise.

### IV.1 Burimet per sektorin e Financave Publike

#### IV.1.1 Burimet e brendshme

Tabela qe vijon paraqet shpenzimet per programet buxhetore te Ministrise se Financave (ne milione Lek), duke perfshire dhe shpenzimet qe i takojne dy administrative, tatimore dhe doganore. Shifrat deri ne vitin 2010 i referohen planifikimeve per PBA 2008-2010, ndersa per vitet ne vijim ato jane vleresime te Ministrise se Financave, mbi bazen e supozimit qe perqindja e burimeve buxhetore per sektorin e financave publike ndaj totalit te buxhetit mbetet e pandryshueshme dhe duke supozuar nje rritje ekonomike prej 5% per tre vitet 2011, 2012 dhe 2013. Kolona e pare e tabelës rendit kater shtyllat e strategjise se sektorit publik, ne korespondence te programeve buxhetore qe ato perfshijne. Disa nga programet buxhetore (Programe te Tjera) te Ministrise se Financave nuk lidhen direkt me asnje shtylle te strategjise.

Tabela IV.1 Burimet e brendshme te parashikuara per periudhen 2008-2013

Shtylla e strategjise	Programet e PBA-se	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Permiresimi i menaxhimit te financave publike	Menaxhimi i shpenzimeve publike (1)	261	341	360	385	408	433	459
Modernizimi i menaxhimit te borxhit	Auditimi i brendshem i financave publike (2)	49	54	57	65	69	73	77
Forcimi i performances dhe besueshmerise se administratave tatimore dhe doganore	Menaxhimi i te ardhurave tatimore (5)	1670	1750	1830	1922	2018	2120	2226
	Menaxhimi i te ardhurave doganore (6)	1205	1705	1550	1612	1677	1744	1814
Programe te tjera (jo te lidhura direkt me shtyllat e	Planifikim, menaxhim dhe administrim (3)	209	229	237	255	268	281	295

strategjise)								
Ekzekutimi I pagesave (4)	250	220	220	220	200	180	168	
Lufta kunder transaksioneve financiare jo ligjore	42	44	45	47	49	51	53	
Ministria e Financave, total	3,686	4,343	4,299	4,506	4,689	4,882	5,092	

Perkufizime: 1. Menaxhimi i shpenzimeve publike i cili perfshin parashikimet makro-fiskale, pergatitjen e buxhetit, zbatimin e tij, thesarin dhe menaxhimin e borxhit. 2. Politikat dhe Metodologjia e Auditimit te Brendshem te Financave Publike ne Sektorin Publik; 3. Administrimi i aparatit te Ministrise se Financave; 4. Kryerja e pagesave (demshperblimet) ne emer te Qeverise per denimet e padrejta nga sistemi gjyqesor dhe kryerja e pagesave per stafin politik te Qeverise (edhe te tjere) si kompensim mbi pagen e tyre; 5-6. Grumbullimi i te ardhurave nga taksat dhe tarifat sipas legjislacionit ne fuqi.

Burimi: Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit per programet buxhetore te Ministrise se Financave, PBA 2008-2010; vleresime te stafit.




Tabela qe vijon tregon shperndarjen e burimeve sipas llojit te shpenzimit (paga, shpenzime te tjera korente, dhe shpenzime kapitale) per secilin program buxhetor per vitin 2007.

Tabela IV.2 Shperndarja e burimeve te brendshme sipas programeve buxhetore per vitin 2007

Programi buxhetor	Paga (%)	Te tjera korente (%)	Kapitale (%)
Planifikim, menaxhim dhe administrim	35.5	48	17
Parashikimet makroekonomike dhe fiskale	100	0	0
Ekzekutimi I pagesave	0	100	0
Planifikimi I buxhetit	100	0	0
Ekzekutimi I buxhetit	79	21	6
Menaxhimi I borxhit	100	0	0
Kontrolli financiar dhe auditimi I brendshem	49	51	0
Lufta kunder transaksioneve financiare jo ligjore	66.7	28.5	4.8
Ministria e Financave	40.8	54.6	4.6
Administrata tatimore	70.1	20.3	9.6
Administrata doganore	75.1	18.6	6.3

## IV.1.2 Burimet e jashtme

Tabela që vijon rendit projektet kryesore me financim të huaj për sektorin e Financave Publike<sup>6</sup>.

Tabela IV.3 Projektet e huaja për sektorin e Financave Publike

Donatori	Projekti	Fusha e politikës	Shuma totale, mln Eur	Kohegjatja/Statusi
Hollande, Suedi, UK	“Forcimi i Menaxhimit të Shpenzimeve Publike”	Permirësimi i shpenzimeve publike/Planifikimi i buxhetit	5.9	2006-2008
EU-Albania CAFAO	“Mbështetje për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të RSH” (Tatime dhe Dogana)	Zbatimi i detyrave sipas planit strategjik të Doganës Shqiptare për periudhën 2008-2013	3.0	Aplikuar në dhjetor 2006
CARDS (fqinjësia Shqiperi-Greqi)	“Ngritja e një pike të re të kalimit të kufirit në Qafë Botë, Konispol” (Tatime dhe Dogana)	Nxitja e bashkëpunimit dhe tregtisë me Greqinë	2.3 (25% financim lokal)	Aplikuar në tetor 2006
CARDS 2004-PAMECA	“Ngritja e pikës së përbashkët të kalimit të kufirit midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, Murriqan, Shkodër” (Tatime dhe Dogana)	Nxitja e një bashkëpunimi me të frytshëm midis dy vendeve	1.6	Marreveshja gati për nënshkrim
CARDS 2004 (binjakezim Shqiperi-Gjermani)	“Projekt binjakezimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Zyres së Policisë Federale Gjermane. Asistencë teknike dhe materiale”	Nxitja e bashkëpunimit të frytshëm mes të dy paleve dhe rritja e efikasitetit në parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.	1.7	2007-2009
Qeveria Italiane	“Mezzogiorno-Zona e Ballkanit” (Tatime dhe Dogana)	Përmirësimi i procedurave doganore në kufijtë kombëtare përgjatë seksionit të rrugës së Korridorit VIII	0.3	Marreveshja a po negociohet
UNCTAD	“Zhvillimi i sistemit të integruar të informatizimit në Doganë, bazuar në programin ASYCUDA” (Tatime dhe Dogana)	Vazhdimësi në asistencën teknike për sistemin ASYDUDA, asistencë teknike dhe strategjike, mbështetje dhe trajnim në përputhje me standardet evropiane dhe praktikën më të mirë	Nuk ka të dhëna	Marreveshja a po negociohet
BE-Albania CAFAO	“Tatime dhe Dogana”	Administrimi i sistemit tatimor	Nuk ka të dhëna	2005-2008
SIDA-Qeveria Suedeze	“Tatime dhe Dogana”	Administrimi i sistemit tatimor	Nuk ka të dhëna	2007
CARDS 2005	“Permirësimi i zyrave në rrethet e Ministrisë së Financave”	Permirësimi i shpenzimeve publike/Ekzekutimi i buxhetit	1.0	2006-2007
SHBA-USAID	“Programi për permirësimin e kerkesave për pjesëmarrje në Millennium Challenge Account”	Administrimi i sistemit tatimor	Mln\$ 5.44	2006-2008

<sup>6</sup> Lista e projekteve u përgatit nga Sekretariati Teknik i Donatoreve në qershor 2006. Tabela nuk përmban projekte të vogla asistencë prej të cilave përfiton Ministria e Financave dhe institucionet e varura prej saj (p.sh. OECD SIGMA) sepse informacioni për këto projekte nuk është plotësisht i disponueshëm.

INËENT-Qeveria Gjermane	Tatime dhe Dogana	Administrimi I sistemit tatimor	Nuk ka te dhena	2007?
Kredi				
Banka Boterore	Reforma ne administraten tatimore	1. Permiresimi i shpenzimeve publike Politika e buxhetit, menaxhimi I thesarit	4.5 [\$5.7]	2000-2006

Nje llogaritje e perafert tregon se Ministria e Financave dhe dy Agjencite e te ardhurave perfitojne rreth €8 milion ne vit mbeshtetje nga burimet e huaja, (ose pothuajse 30% te burimeve qe ata perfitojne nga buxheti I shtetit).

Tabela IV.4 Burimet nga financimet e huaja sipas programeve buxhetore (mln leke)

Shtylla e strategjise	Programet e PBA-se	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
1. Permiresimi I menaxhimit te financave publike	Menaxhimi i shpenzimeve publike (1)	50	50					
3. Modernizimi I menaxhimit te borxhit	Auditimi i brendshem i financave publike							
4. Forcimi I performances dhe besueshmerise se administratave tatimore dhe doganore	Menaxhimi i te ardhurave tatimore		427					
	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave		560					

## IV.2 Nevojat per burime ne te ardhmen

Seksioni merr ne shqyrtim politikat e vecanta te seciles shtylle te strategjise dhe implikimet e tyre ne terma investimesh, ne vecanti ato investime qe kane nevojte per burime shtese. Ai vlereson gjithashtu burimet alternative per financimin e ketyre politikave.

Ne kete seksion diskutohen gjithashtu kerkesat per burime njerezore shtese. Sic e theksuam dhe me pare, permiresimi i menaxhimit do jete burimi kryesor per financimin e programeve qe kane per qellim ngritjen e kapaciteteve te brendshme. Ketu shqyrtohet gjithashtu edhe mundesia per rialokime te burimeve njerezore drejt fushave me vlere me te madhe strategjike.

### IV.2.1 Investimet

Nje numer politikash qe permbahen ne kapitullin e trete, ne vecanti por jo vetem ne administratat tatimore dhe doganore, implikojne investime ne fushen e teknologjise se informacionit. Keto investime jane te kushtueshme dhe nuk mund te perballohen nga buxhetet e brendshme. Tabela qe vijon ben nje permbledhje te planeve per investim dhe tregon kostot e peraferta te tyre.

Tabela IV.5 Investimet sipas fushes se politikave per zbatimin e strategjise<sup>7</sup>

Fusha e politikave	Politikat	Kostot
<b>1. Permiresimi I menaxhimit te financave publike</b>		
Parashikimet makro dhe fiskale		
Planifikimi dhe zbatimi I investimeve publike		
Sistemi i menaxhimit te shpenzimeve publike		
Menaxhimi dhe kontrolli I Thesarit	Dizenjimi dhe zbatimi I sistemit te kompjuterizuar te Menaxhimit te Thesarit Komunikimi On-line midis: <ul style="list-style-type: none"> <li>Ministrise se Financave dhe degeve te thesarit ne rrethe</li> <li>Ministrise se Financave dhe DPT dhe DPD si dhe 4 ministrite kryesore</li> </ul>	
Kontabiliteti, kontrolli i brendshem dhe auditu		
Marredheniet fiskale nderqeveritare		
<b>2. Zgjerimi i bazes tatimore dhe perputhja e politikave tatimore me perparesite kombetare</b>		
Shperndarja e barres se taksave ne menyre me te drejte.		
Sistem taksash qe mbeshitet formulimin e politikave fiskale te drejta dhe nxitese per zhvillimin ekonomik dhe te biznesit.		
Perputhja e politikave mbi taksat indirekte me ato te BE-se.		
<b>3. Modernizimi i menaxhimit te borxhit</b>		
Rritja e perudhes se maturimit te huamarrjes se brendshme, diversifikimi I bazes se investitoreve vendas	Zhvillimi i tregut te brendshem per bonot e thesarit	
Vendosja e nje balance me te mire midis borxhit te brendshem dhe te jashtem		
Ulja e stokut te borxhit te brendshem ndaj PBB-se.		
Krijimi i nje sistemi te integruar menaxhimi te borxhit.	Krijimi I Drejtorise se Pergjithshme te Menaxhimit te Borxhit. Modernizimi i sistemeve te depozitimit dhe ruajtjes	
<b>4. Forcimi i performances dhe besueshmerise se administratave tatimore dhe doganore.</b>		
Identifikimi i burimeve kryesore te evazionit fiskal dhe reduktimi i hendekut tatimor.		
Rritja e cilesise se sherbimit ndaj taksapaguesve.	Ndermarrja e nje fushate intensive edukative mbi te drejtat dhe pergjegjesite e taksapaguesve Ndrertimi I nje kompeksi te ri doganor ne Fier	\$ 400,000 <sup>8</sup>
Mbrojtja e tregjeve dhe e shoqerise.		
Rritja e performances, kontrollit mbi menaxhimin dhe auditit.	Krijimi I nje sistemi te integruar taksash: <ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi I nje rrjeti IT te besueshem, midis DPT dhe 15 degeve tatimore kryesore (ne gjithe vendin)</li> <li>Instalimi i nje Sistemi per Menaxhimin e Informacionit (MIS)</li> <li>Permiresime te kushteve fizike te punes</li> </ul>	\$ 235,000 \$ 300,000 \$ 600,000 <sup>9</sup>

<sup>7</sup> Pjeset me te erreta te tabelës i referohen politikave që implikojne burime financiare te konsiderueshme.

<sup>8</sup> Kostot e indikuara ne kete table do te perballohen nga programi I Millenium Challenge Corporation.

<sup>9</sup>Vetem per degen e Tiranes.



	Krijimi I njesise se antikorrupsionit ne DPT	\$ 300,000
	Krijimi I Gjykates Tatimore (shkalla e dyte e mbrojtjes)	\$ 300,000
	Zbatimi i sistemit ASYCUDA WORLD	
	Ndertimi i Terminalit Shqiptar te Doganave	
Pershpejtimi i progresit te reformave ne administratat tatimore dhe doganore per plotesimin e kerkesave te BE-se.	Rritja e kompjuterizimit te procedurave doganore, shtrirja e sistemit ASYCUDA ne te gjitha pikat doganore.	

Krijimi i Agjencise Kombetare per te Ardhurat paraqet investimin me domethenes per vitet ne vijim. Kjo strategji nuk ben asnje vleresim per koston dhe perballimin e saj per mungese informacionesh.

#### IV.2.2 Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerezore

Per arritjen e qellimeve te strategjise, vemendje e vecante do t'i kushtohet permiresimit te kompetencave organizative brenda Ministrise se Financave, Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve dhe Drejtorise se Pergjithshme te Doganave. Keto ndryshime ne kapacitete dhe organizim kerkojne vemendje aktive dhe te vazhdueshme nga ana e drejtuesve administrative dhe politik dhe nuk mund te arrihen vetem me rritje te numrit te punonjesve dhe shtimin e financimeve. Krijimi i kompetencave organizative nenkupton krijimin e aftesive, proceseve, mjedisit te menaxhimit, njohurive institucionale, vlerave dhe reputacionit te nevojshme per kete qellim.

- Ministria e Financave duhet te krijojte nje kulture te forte te bazuar ne dije, me nje staf te angazhuar dhe shume profesional i cili, nepermjet analizave te shendosha, keshillave te mire peshuara mbi politikat dhe shembullit te mire, te luaje rolin e lidershipit ne sektorin publik shqiptar.
- Sfida e Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve eshte transformimi ne nje agjenci publike qe gezon respektin e qytetareve dhe eshte e besueshme ne kryerjen e detyrave te saj: mbledhja e taksave, parandalimi i evazionit fiskal, rritja e pajtueshmerise vullnetare.
- Drejtoria e Pergjithshme e Doganave ka pergjegjesine e te qenit nje "dritare" ne marredheniet e Shqiperise me vizitoret dhe tregtaret e huaj, per t'i vertetuar vendeve te Europes qe Shqiperia eshte plotesisht ne gjendje te marre pjese ne nje regjim te perbashket kufitar europian.

Aktualisht jane ndermarre mjaft iniciativa per permiresimin e kapaciteteve ne funksione dhe procese te vecanta. Megjithate, mungon ende brenda Ministrise se Financave vleresimi dhe institucionalizimi i ketyre iniciativave. Strategjia i vendos keto iniciativa ne kuadrin e zhvillimit te kompetencave organizative te sektorit te financave publike, dhe ka per qellim te forcoje menaxhimin dhe vazhdimesine e tyre ne kohe.

Tabela qe vijon permbledh aktivitetet qe lidhen me menaxhimin e burimeve njerezore, prej te cilave perfiton jo vetem Ministria e Financave dhe dy drejtorite e pergjithshme, por edhe ministrite e linjes.

**Tabela IV.6 Aktivitetet per menaxhimin e burimeve njerezore ne kuader te Strategjise**

Fusha e politikës	Trajnime dhe menaxhim te burimeve njerezore
1. Permiresimi I menaxhimit te financave publike	
Parashikimet makro dhe fiskale	Trajnim I stafit te drejtorise se politikave fiskale dhe makro ne lidhje me modelin e makros dhe parashikimet fiskale.

Planifikimi dhe zbatimi i investimeve publike	Trajnim i ministrive te linjes per procedurat e investimeve publike. Trajnim i stafit te drejtorise se investimeve publike per procedurat e reja dhe analizat kosto perftim.
Sistemi i menaxhimit te shpenzimeve publike	Trajnim i ministrive te linjes per procedurat e buxhetit afatmesem Krijimi i nje kuadri menaxhimi me te forte per te monitoruar procesin e menaxhimit te shpenzimeve publike.
Menaxhimi dhe kontrolli i Thesarit	Trajnim i stafit te Thesarit per parashikimin e cash-it. Trajnim i ministrive te linjes dhe njesive te varura prej tyre per sistemin e kompjuterizuar te thesarit.
Kontabiliteti, kontrolli i brendshem dhe auditit	Trajnim i stafit te drejtorise se auditit per metodologjine e harmonizuar. Trajnim i ministrive te linjes per harmonizimin e rekordeve financiare dhe standardet e kontabilitetit dhe kontrollit te brendshem.

## Marredheniet fiskale nderqeveritare

**2. Zgjerimi i bazes se taksueshme dhe perputhja e politikave tatimore me prioritetet kombetare**

Shperndarja e barres se taksave ne menyre me te drejte.	Trajnim, ne bashkepunim me njesite politikeberese te Tatimeve dhe doganave, i stafit te politikave fiskale per rritjen e kapaciteteve politikeberese (perfshire dhe parashikimin e te ardhurave).
Sistem taksash qe mbeshket formulimin e politikave fiskale te drejta dhe nxitese per zhvillimin ekonomik dhe te biznesit.	Rritja e kapaciteteve per formulimin e politikave fiskale dhe per ndryshime ne legjislacionin tatimor .
Perputhja e politikave mbi taksat indirekte me ato te BE-se.	Trajnim i stafit te politikave fiskale per angazhimet e harmonizimit te legjislacionit fiskal (per taksat indirekte) me ate europian.

**3. Modernizimi i menaxhimit te borxhit**

Rritja e periudhes se maturimit te huamarrjes se brendshme, diversifikimi i bazes se investitoreve vendas  
Vendosja e nje balance me te mire midis borxhit te brendshem dhe te jashtem

Ulja e stokut te borxhit te brendshem ndaj PBB-se.

Krijimi i nje sistemi te integruar menaxhimi te borxhit.	Krijimi i Drejtorise se Pergjithshme te Menaxhimit te Borxhit; rritja e kapaciteteve te stafit (perfshire analizat e qendrueshmerise se borxhit)
--	--

**4. Forcimi i performances dhe besueshmerise se administratave tatimore dhe doganore.**

Identifikimi i burimeve kryesore te evazionit fiskal dhe reduktimi i hendekut tatimor.

Rritja e cilesise se sherbimit ndaj taksapaguesve.

Mbrojtja e tregjeve dhe e shoqerise.

Rritja e performances, kontrollit mbi menaxhimin dhe auditit.

Pershpejtimi i progresit te reformave ne administratat tatimore dhe doganore per plotesimin e kerkesave te BE-se.

Forcimi i menaxhimit te pajtueshmerise vullnetare me taksat.

Zhvillimi dhe shperndarja e programeve edukative per taksapaguesit; trajnimi i stafit per ofrimin e sherbimeve me cilesi te larte.

Rritja e njohurive te stafit per procedurat  
Trajnimi i auditoreve mbi procedurat e reja per analizen e riskut.

Rialokimi i stafit nga biznesi i vogel tek taksapaguesit e medhenj  
Rialokimi i stafit pas mbylljes se degeve te vogla tatimore dhe transformimin e tyre ne zyra sherbimi.

Racionalizimi i perdorimit te Policise Tatimore; rialokimi i stafit brenda strukturave te Policise.

Forcimi i strukturave antikorrupsion.

Trajnimi i stafit ne DPT dhe DPD ne lidhje me standardet e reja te perafuara me Acquis.

Forcimi i kapaciteteve administrative dhe njerezore te Doganave ne luften kunder evazionit fiskal, korrupsionit dhe kontrabandes.

Ministria e Financave do te pergatise nje plan veprimi ne lidhje me trajnimet, ne menyre qe te sigurohet planifikimi i drejte i aktiviteve te lartpermendura, jo vetem neper vite por edhe brenda cdo viti.

Mbetet ende nje teme e pa diskutuar ne Ministrine e Financave ceshtja e rialokimit te stafit. Ky do te jete nje prioritet per stafin drejtues te Ministrise, pasi te jete pasuruar baza e informacionit ne lidhje me alokimin e burimeve, si pasoje e permiresimit te programeve te PBA-se dhe te strukture se kostove. Ky permiresim do te jete rezultat i Per shembull, ne fushen e menaxhimit te shpenzimeve publike, por jo vetem, mund te shqyrtohet ceshtja e rialokimit te burimeve njerezore lidhur me vendimin e mundshem per te ulur (ose mos ofruar) sherbimet e thesarit neper rrethe, kur decentralizimi te kete marre zhvillim.

Tabela qe vijon krahason strukturen dhe volumin e personelit ne sektoret e financave publike te Shqiperise dhe Sllovenise, nje nga vendet e anetaresuara vitet e fundit ne BE, me permasa te ngjashme me vendin tone. Edhe ky krahasim mund te perdoret si nje indikator i mundshem i nevojave per burime njerezore.

Tabela IV.7 Struktura e personelit ne sektorin e financave publike te Shqiperise dhe Sllovenise

Drejtorite e Pergjithshme	Departamentet	Shqiperia	Sllovenia
Politikat makroekonomike dhe fiskale		14	38
	Parashikimet makro dhe fiskale	7	4
	Politika fiskale	7	34
Buxheti		31	74 <sup>10</sup>
	Analiza dhe politika buxhetore	8	
	Menaxhimi dhe zbatim i buxhetit	13	
	Menaxhimi i investimeve publike	8	
Thesari		32	184 <sup>11</sup>
	Thesari	7	18
	Menaxhimi i borxhit	8	14
	Kontabiliteti	8	122
	Menaxhimi i prones publike	7	30
Auditi	Auditi i brendshem		
	Metodolgjia dhe statistikat	9	
	Mbikqyrja dhe hetimi	10	

### IV.3 Menaxhimi i Strategjise

Strategjia do te kerkoje burime te reja dhe perdorim me te mire te burimeve ekzistuese per zbatimin me sukses te saj. Per shfrytezimin sa me mire te burimeve njerezore, financiare dhe teknike, per arritjen e qellimeve te strategjise, eshte menduar qe:

10 Duke perfshire edhe nje departament per menaxhimin e fondeve te BE-se .

11 Kjo mbulon drejtorine e thesarit, drejtorine e menaxhimit te prones publike, dhe drejtorine e kontabilitetit publik.

- Te kete nje proces menaxhimi strategjik te terthorte ne sektorin e Financave Publike, qe do te perfshije te tre organizatat e interesuara.
- Ministria e Financave, DPT dhe DPD te forcojne procesin e tyre te menaxhimit te burimeve.

Ne lidhje me procesin e pare, grupi i punes per Buxhet, Integrim dhe Strategji ne Ministrine e Financave do te monitoroje zbatimin e strategjise dhe do te merret me ceshtje si vendosja e prioriteteve per financimin e jashtem, dhe percaktimi i pergjegjesive ne lidhje me politikat dhe zbatimin e tyre.

Punonjesit me me shume eksperience te seciles organizate do t'i kushtojne me shume vemendje dhe kohe procesit te menaxhimit te burimeve. Secila nga organizatat do ta perktheje strategjine ne plane pune, nepermjet procesit te PBA-se, te cilat do te vendosin prioritete dhe do te alokojne burime, si dhe do te monitoroje ne menyre aktive rekrutimin dhe zhvillimin e karrierave ne sektoret strategjike. Do te ngrihet nje sistem per menaxhimin e performances dhe kontrollin, qe do te delegoje komponentet e vecante te strategjise te "menaxhere" individuale dhe do t'i mbaje ata pergjegjes per zbatimin e tyre. Struktura e programeve buxhetore, ne kuadrin e PBA-se, do te zhvillohet me tej ne menyre qe te permbaje me shume informacion te dobishem ne lidhje me prioritetet strategjike, politikat dhe koston e realizimit te tyre.

## V PERGJEGJESIA, MONITORIMI DHE VLERESIMI

Kapitulli i fundit i ketij dokumenti paraqet indikatorët dhe proceset e vleresimit dhe te monitorimit qe do te perdoren per vleresimin e progresit drejt objektivave te Strategjise sektoriale te Financave Publike. Ketu trajtohen gjithashtu edhe temat e konsultimit dhe te transparences, procese qe do te ndihmojne ne rritjen e pergjegjshmerise se tre institucioneve te Financave Publike, nepermjet aktivizimit te aktoreve te brendshem dhe te jashtem dhe te publikut te gjere per konsultimin dhe njohjen me Strategjine.

### V.1 Standardet dhe proceset e monitorimit nderkombetar

Per sektorin e financave publike ekzistojne nje numer i madh standartesh, matjesh dhe procesesh monitorimi. Qeveria e Shqiperise eshte angazhuar ne respektimin e disa prej tyre, te pranura dhe te perdorura ne nivel nderkombetar. Disa nga keto standarte, te lidhura me funksionet qe perfshihen ne Strategji, trajtohen gjeresisht me poshte.

#### V.1.1 Kuadri i Monitorimit PEFA (*Public Expenditure and Financial Accountability*) per Menaxhimin Publik Financiar

Kuadri i Matjes se Performances per Menaxhimin Publik Financiar (MPF) eshte nje kuader monitorimi i integruar qe lejon matjet e performances se vendeve ne lidhje me menaxhimin publik financiar, ne kohe te ndryshme. Ky kuader eshte zhvilluar me perpjekjet e perbashketa te partnereve te PEFA-s ne bashkepunim me OECD/DAC *joint venture*. PEFA eshte nje agjenci shumepaleshe e sponsorizuar nga Banka Boterore, Fondi Monetar Nderkombetar, Komisioni European, Departamenti Britanik per Zhvillimin Nderkombetar, Ministria Franceze e Puneve Te Jashtme, Ministria e Puneve te Jashtme e Norvegjise, Sekretariati I Shtetit per Ceshtjet Ekonomike te Suedise, dhe Partneriteti Strategjik Per Afriken. Kuadri perfshin nje grup indikatorësh me cilesi te larte, te bazuar ne indikatorët HIPC per shpenzimet, ne Kodin e Transparences Fiskale dhe ne standarde te tjera nderkombetare. Kuadri perfshin gjithashtu edhe nje raport performance mbi MPF-ne bazuar ne indikatorët perkates.

Kuadri i Matjes se Performances identifikon gjashte dimensionë kyce te nje sistemi te shendoshe menaxhimi publik financiar. Keto jane:

1. Besueshmeria e buxhetit - Buxheti eshte realist dhe zbatohet ne menyren e planifikuar.
1. Transparenca dhe gjithepershirja - Monitorimi i buxhetit dhe i riskut fiscal eshte gjithepershires dhe informacioni mbi buxhetin eshte i aksesueshem nga publiku.
2. Buxheti bazuar ne politika - Buxheti pergatitet bazuar ne politikat e qeverise.
3. Parashikueshmeria dhe kontrolli ne zbatimin e buxhetit - Buxheti zbatohet ne menyre te rregullt dhe te parashikueshme, dhe ka marreveshje ne lidhje me ushtrimin e kontrollit mbi perdorimin e fondeve publike.
4. Kontabiliteti, regjistrimet dhe raportimi - Regjistrimet dhe informacioni qe prodhohen dhe shperndahen jane te pershtatshme per qellime kontrolli te vendimarrjes, menaxhimi dhe raportimi.
5. Shqyrtimi dhe auditi i jashtem - Marreveshjet (institucionale) ne lidhje me shqyrtimin dhe kontrollin e financave publike funksionojne ne menyre te drejte.

Raporti i fundit i PEFA per Shqiperine i referohet periudhes qershor 2005-korrik 2006 dhe eshte pjese e *Country Fiduciary Assessment* (CFA) dhe *Public Expenditure and Institutional Review* (PEIR).

Ky sistem indikatorësh dhe matjesh lidhet direkt me tre nga kater shtyllat e Strategjise se Financave Publike, dhe do te sherbeje si nje baze shume e rendesishme per monitorimin e Strategjise. Strategjia nuk vendos objektiva performance sasiore dhe kohore bazuar ne PEFA, por pritet ta beje kete ne te ardhmen. Raportet e PEFA perbejne dhe baze per krahasime rajonale per keta indikatore.

### V.1.2 Raportet mbi Zbatimin e Standarteve dhe Kodeve

Eshte nje sistem nderkombetar i monitorimit te financave publike, ku ka aderuar Shqiperia, dhe perbehet nga Raportet e FMN-se mbi Zbatimin e Standarteve dhe Kodeve (Report on the Observance of Standards and Codes).

Nje nga fushat e monitorimit te ROSC ka te beje me statistikat makroekonomike. Raporti i ROSC i muajit mars 2006 eshte nje rivleresim bazuar ne Kuadrin Vleresues te Cilesise se te Dhenave (*DQAF Data Quality Assessment Framework*), te Korrikut te vitit 2003, i cili eshte instrumenti qe perdor FMN per vleresimin e sistemit te statistikave kombetare. DQAF permban praktiket e pranuar ne rang nderkombetar per statistikat, duke nisur nga qeverisja e mire e agjencive qe prodhojne te dhena deri tek praktiket qe lidhen me baza specifike te te dhenave. Ne lidhje me kete, Ministria e Financave eshte pergjegjese per mbledhjen dhe shperndarjen e te dhenave per operationet e Qeverise Qendrore (per shembull procedurat e kontabilitetit dhe te raportimit) si dhe per borxhin e jashtem, te dyja fusha te rendesishme per matjen dhe monitorimin e strategjise se Financave Publike.

Vleresimi per cilesine e te dhenave bazohet ne gjashte dimensione: kriteret e cilesise; sigurimi i integritetit; forca dhe saktesia e metodologjise; korrektesia dhe besueshmeria; dobishmeria dhe aksesueshmeria; periodiciteti, korrektesia dhe mbulimi i te dhenave. Ne lidhje me dimensionin e fundit, Shqiperia i tejkalojne rekomandimet e Sistemit te Shperndarjes se te Dhenave (GDDS).

Fusha tjeter e monitorimit te ROSC eshte ajo e Transparences Fiskale, raportet e fundit te se ciles i referohen vitit 2003. Ne kete rast, standardet e aplikuara permbahen ne Kodin e Praktikave te Mira per Transparencen Fiskale. Fushat kryesore te perfshira, qe lidhen me Strategjine, kane te bejne me:

- Legjislacionin fiskal dhe procedurat tatimore, duke perfshire: ligjet dhe rregulloret, auditimi dhe kontrolli, parashikimi i te ardhurave, udhezimet dhe shperndarja e tyre tek taksapaguesit ne menyre te aksesueshme, procedurat e apelimit, publikimi i analizave tatimore dhe kostot e lehtesirave fiskale, ne terma te humbjes se te ardhurave.
- Cilesine e pergatitjes se buxhetit, duke perfshire: dokumentacioni dhe klasifikimet e buxhetit, cikli i buxhetit, perfshirja e Parlamentit, transparencja ndaj publikut, shtrirja dhe trajtimi i rialokimeve, trajtimi i kredive te huaja dhe granteve, lidhja midis buxhetit vjetor dhe PBA-se, analiza buxhetore, vleresimi i propozimeve per investim, dhe raportimi mbi pushtetin vendor.

### V.1.3 Angazhimet per Integrimin European, Standardet dhe Proceset e Monitorimit

Marreveshja e Stabilizim Asocimit permban angazhime konkrete ne lidhje me sektorin e Financave Publike, perfshire dhe administratat tatimore dhe doganore. Angazhimet

perbejne nje standard ne nivel rajonal (Bashkimi European), kundrejt te cilit Qeveria e Shqiperise dhe Komisioni European matin dhe monitorojne progresin e Shqiperise, sipas afateve kohore te vendosura ne Planin e Zbatimit te MSA-se. Plani Kombetar i Zbatimit te Marreveshjes se Stabilizim Asocimit nuk permban indikatore specifike per progresin e bere ne lidhje me angazhimet por vetem angazhime dhe afate kohore te lidhura me to. Ne lidhje me kete plan, Ministria e Financave si dhe DPT dhe DPD, raportojne tre muaj per progresin e bere ne lidhje me objektivat e percaktuara ne Plan. BE mbi bazen e ketyre dhe informacioneve te tjera pergatit cdo vit nje Progres Raport mbi ecurine e reformave ne Shqiperi duke u perqendruar ne fushat e procesit te Stabilizim Asocimit (situate politike, ekonomike dhe zbatimi i detyrimeve te MSA-se).

#### V.1.4 Aktivitete te tjera matje, monitorimi dhe vleresimi

Percet proceseve formale nderkombetare te vendosjes se standardeve dhe te monitorimit te pershkruara me lart, ka dhe nje sere vleresimesh, periodike dhe jo, te organizmave financiare nderkombetare dhe donatoreve, qe ndihmojne qeverine per matjen dhe monitorimin e fushave specifike te financave publike.

Ne kuader te Korporates per Sfiden e Mijevjecarit (MCC), programi per Permiresimin e Krieteve per Perfitimin nga Llogaria e Sfides se mijevjecarit (me kohezgjatje 24 muaj), te rendesishem jane indikoret e vendosur per reformimin e administrates tatimore drejt eliminimit te korrupsionit. Impakti i ketij programi do te matet nepermjet indeksit MCC per politiken e taksave dhe indikatorit te “*tax buoyancy*”.

Rendesi te vecante ne kete grup ka Rishikimi Institucional dhe i Shpenzimeve Publike te Bankes Boterore (PEIR), marreveshjet midis Qeverise dhe FMN-se lidhur me fondet e FMN-se (Memorandumi i Politikave Ekonomike dhe Financiare, Memorandumet Teknike te Mirekuptimit, ne kuader te Konsultimeve nen Artikullin IV), marreveshjet e kredise me Banken Boterore (per shembull *Development Policy Loan*, dhe te tjera).

Gjithashtu te rendesishme jane edhe planet e veprimit te miratuara nga Qeveria ne lidhje me Menaxhimin e Investimeve, Menaxhimin e Borxhit dhe Parashikimet Makro dhe Fiskale. Keto perbejne standarde kundrejt te cilave mund te matet progresi.

## V.2 Monitorimi i strategjise se Financave Publike

Krahas proceseve te pershkruara me lart, pa dyshim qe edhe vete Strategjia do te sherbeje si baze per monitorim te ardhshem te progresit te bere ne fushen e Financave Publike. Sfida e matjes se progresit ne drejtim te “...mobilizimit te te ardhurave ne menyre qe te mbeshtetet sa me mire arritja e objektiveve te brendshem dhe nderkombetare te Shqiperise, dhe marrjes se rezultateve me te mira nga shpenzimet publike dhe investimet” konsiston ne vendosjen e objektiveve dhe te planeve kohore kundrejt plotesimit te standarteve. Kjo strategji nuk e realizon kete funksion, keshtu qe ai do te perbeje prioritet per strategjine e ardhshme sektoriale.

Me poshte vijon nje permbledhje e indikatoreve per matjen dhe monitorimin e te kater shtyllave te strategjise se Financave Publike.

### V.2.1 Permiresimi i menaxhimit te financave publike.

Ne tabelat qe vijojne, kemi quajtur indikatore PEFA ata qe i referohen raportit te PEFA-s per periudhen korrik 2005-gusht 2006; indikatore ROSC ata qe i referohen raportit (ROSC)

te FMN-se Korrik 2003 mbi Transparençen Fiskale; dhe indikatore DQAF ata qe i referohen raportit te FMN-se mbi Zbatimin e Standardeve dhe Kodeve te marsit 2006.

Tabela V.1 Indikoret qe lidhen me permiresimin e cilesise se shpenzimeve publike

	Indikatori	Performanca aktuale	Burimi aktual	Burimi I ardhshem	Vlera sipas raporteve te fundit
PEFA-1	Shpenzimet agregate faktike ne krahasim me buxhetin	Devianca eshte ulur qe nga 2002, nga 7.3% ne 1.27%. Besohet se procesi I PBA-se ka kontribuar ne ruajtjen e stabilitetit fiskal.	PEFA	PEFA	B
PEFA-2	Perberja e shpenzimeve faktike ne krahasim me buxhetin e aprovuar	Varianca e perberjes se shpenzimeve sipas klasifikimit administrativ eshte me e madhe se devianca totale e shpenzimeve paresore me 10 pike perqindje per dy nga tre vjetet e shqyrtuar (2002, 2003, 2004).	PEFA	PEFA	D
PEFA-3	Te ardhurat buxhetore faktike krahasuar me buxhetin	Mbledhja e te ardhurave te brendshme ishte nen 94% te planifikimit buxhetor vetem per nje nga tre vitet e shqyrtuara.	PEFA	PEFA	B
PEFA-4	Stoku dhe monitorimi i shpenzimeve per pagesa te prapambetura.	Per rrogat dhe kontributet ka shume pak pagesa te prapambetura. Nuk ka monitorim te pagesave ne lidhje me kontratat sepse nuk ka kontroll mbi angazhimet ( <i>commitments</i> ).	PEFA	PEFA	D
PEFA-5	Klasifikimi I buxhetit	Klasifikimi funksional eshte ne perputhje me standardet COFOG dhe nivelet nen funksionale. Regjistrimi I transaksioneve me sistemin e ri te klasifikimit nuk eshte testuar ende.	PEFA	PEFA	A
PEFA-6	Informacion gjithepershires ne dokumentat e buxhetit	Buxheti I 2005 ploteson tre nga 9 kriteret e PEFA ne lidhje me kete indikator	PEFA	PEFA	C
PEFA-7	Shtirirja e operacioneve te qeverise qe nuk raportohen, perfshire dhe ato te financuara nga donoret.	Projektet e financuara nga donoret pasqyrohen shume pak ne buxhet, duke shkaktuar mosperputhje te te dhenave dhe ulje te aftesise se planifikimit.	PEFA	PEFA	D+
PEFA-8	Transparenca e marredhenieve fiskale nderqeveritare.	Pushteti vendor ka vuajtur nga vonesat e informacioneve ne lidhje me transfertat dhe nga mekanizmat e paqarte te alokimeve te transfertave te kushtezuara. Nga ana tjeter, pushtetet vendore kane detyrimin te paraqesin raporte mbi shpenzimet aktuale, ne menyre konsistente dhe ne kohen e duhur.	PEFA	PEFA	C+
PEFA-9	Monitorimi i riskut agregat fiskal qe vjen nga njesi te tjera te qeverisjes qendrore.	Bilancet e Ndermarrjeve Publike dhe Agjencive te Pavarura nuk jane te monitoruara sic duhet dhe si rrjedhim mund te kthehen ne burime detyrimesh per qeverine.	PEFA	PEFA	C+
PEFA-10	Aksesi publik ndaj informacioneve baze fiskale	Qeveria jep akses per publikun per 4 nga 6 dokumentet fiskale te listuara ne indikatorin e PEFA-s	PEFA	PEFA	B
PEFA-11	Rregullsia proceduriale dhe pjesemarrja ne procesin e buxhetit	Shqiperia ka nje kalendar fiks per buxhetin, qe perfshin grupet e ndryshme te interesit ne proces. Parlamenti e aprovon buxhetin para	PEFA	PEFA	A



	vjetor	fillimit te vitit te ri fiskal.			
PEFA-12	Perspektiva shumevjecare e planifikimit fiskal, politikes se shpenzimeve dhe e buxhetimit.	Qeveria vendosi pergatitjen e PBA-se ne vitin 2001 dhe qe ateherë ka patur progres ne menaxhimin e shpenzimeve publike. Megjithate, lidhjet midis tavaneve te PBA-se dhe alokimit aktual te burimeve jane te dobeta dhe strategjite sektoriale nuk bejne ende kostim te investimeve dhe vleresim te kostove per shenzime operative.	PEFA	PEFA	C
PEFA-16	Parashikueshmeria e disponibilitetit te fondeve per angazhimet e marra per shpenzime.	Rregullimet buxhetore (rialokime) brenda vitit fiskal jane shume te shpeshta. Ministrive te linjes u jepen kufij shpenzimesh dy mujore si baze per parashikimin e fondeve te disponueshme. Megjithate, percaktimi I ketyre fondeve per shpenzime nuk eshte realist dhe periudha prej dy muajsh eshte e pamjaftueshme per ministrive te linjes te bejne parashikimet e tyre.	PEFA	PEFA	C+
PEFA-17	Regjistrimi dhe menaxhimi I bilanceve te arkës, borxhit dhe garancive.	Cilesia e regjistrimeve kontabel dhe raportimeve ne lidhje me borxhin dhe garancite eshte e larte dhe bilancat e arkës konsolidohen ne menyre te rregullt.	PEFA	PEFA	B
PEFA-18	Efektiviteti I listepagesave (bordero)	Fakti qe listepagesat dhe te dhenat e personelit nuk jane te integruara dhe shpesh te pakomputerizuara demton besueshmerine e sistemit.	PEFA	PEFA	B+
PEFA-20	Efektiviteti I kontrolleve te brendshme per shpenzimet jo per paga	Nuk ka kontrolle mbi angazhimet per shpenzime, kufijte e vendosur per shpenzimet nuk I kufizojne ne te vertete shpenzimet ne nivelin e disponibilitetit te <i>cash</i> . Rregullat dhe procedurat ekzistuese ne disa raste cojne ne perdorim fondesh jo eficente.	PEFA	PEFA	B
PEFA-21	Efektiviteti I auditit te brendshem	Eshte duke u zhvilluar nje sistem modern auditit I brendshem. Mbetet per t'u analizuar impakti I tij mbi efektivitetin e operacioneve te Qeverise.	PEFA	PEFA	C+
PEFA-22	Rregullsia e rakordimit te llogarive kontabel	Rakordimet e bankave ne lidhje me llogarive unike te Thesarit dhe te Bankes se Shqiperise behen cdo muaj	PEFA	PEFA	B provizor
PEFA-23	Disponibiliteti I infromacionit per burimet ne dispozicion te njesive te sherbimit primar.	Informacioni ne lidhje me burimet ne <i>cash</i> te shkollave dhe spitaleve nuk pasqyrohet ne thesar; asnje informacion ne lidhje me burimet ne natyre nuk I jepet qeverise qendrore.	PEFA	PEFA	D
PEFA-24	Korrektesia, cilesia dhe shperndarja e raporteve te zbatimit te buxhetit.	Raportet per zbatimin e buxhetit gjate vitit pergatiten ne kohe, por nuk jepet asnje informacion ne lidhje me angazhimet per shpenzime.	PEFA	PEFA	C+
PEFA-25	Cilesia dhe perpikmeria e bilanceve vjetore te qeverise	Bilancet permbajne informacion te plote dhe jane te perpikte. Pergatitja e tyre eshte ne perputhje me standardet e llogarive kombetare.	PEFA	PEFA	B+

ROSC 2	Dhenia e informacionit per publikun	<p>2.1 Paraqitja e shpenzimeve per mbrojtjen ne dokumentat e buxhetit.</p> <p>2.2 Informacion mbi detyrimet e pritshme</p> <p>2.3 Paraqitja e kostos se politikave tatimore ne Parlament dhe per publikun.</p>	ROSC	ROSC	<p>Shpenzimet per mbrojtjen regjistrohen dhe raportohen sic do shpenzim tjeter.</p> <p>Informacion shume I kufizuar perfshihet ne dokumentat e buxhetit per detyrimet e pritshme.</p> <p>Nuk ka nje vleresim te plote per kostot e koncesioneve dhe lehtesirave tatimore, per t'iu paraqitur parlamentit dhe publikut.</p>
ROSC 3	Pergatitja, zbatimimi dhe raportimi transparent i buxhetit	<p>3.1 Prezantimi I parashikimeve per indikatorët makro dhe te ardhurat ne dokumentat e buxhetit.</p> <p>3.2 Vleresimi I efekteve te politikave te reja dhe te atyre aktuale, vecmas, ne dokumentet e buxhetit.</p> <p>3.3 Raportimi I progresit ne lidhje me objektivat e politikave kryesore, I perfshire ne pjesen shpjeguese te buxhetit.</p>	ROSC	ROSC	<p>Projeksionet per indikatorët makro dhe te ardhurat nuk paraqiten me detaje dhe shpejgimet perkatese.</p> <p>Kostot e aktiviteteve te reja korente nuk jane te ndara nga ato ne vazhdim. Projektet e investimeve dhe detajet e tyre nuk paraqiten individualisht ne buxhet.</p> <p>Progresi aktual I politikave kryesore ekonomike nuk vleresohet perkundrejt objektiveve.</p>
DQAF 0		0.2 Kriteret e cilesise	ROSC	ROSC	LNO: stafi ekzistues eshte I pamjaftueshem per plotesimin e kerkesave te GFS dhe nuk lejon hapësira per nje rritje te barres se punes.
DQAF 2	Metodologjia	2.1 Koncepte dhe perkufizime.	ROSC	ROSC	LO: Llogarite fiskale bazohen gjeresisht ne metodologjine e GFSM 1986, edhe pse ka divergjence ne prezantimin e te dhenave. Nuk ka ende nje proces formal kalimi ne sistemin e GFSM 2001.
DQAF 3	Rregullsia dhe besueshmeria	3.1 Burimi I te dhenave	ROSC	ROSC	LO: dobesia ne burimin e te dhenave qendron kryesisht ne mungesen e te dhenave mbi projektet e financuara me

burime te huaja  
(grante), qe nuk  
kalojne nga sistemi I  
Thesarit.

Perkufizime. LO (*largely observed*-gjeresisht e verejtur): ka disa mangesi, por keto nuk mjaftojne per te ngritur dyshime mbi aftesine e autoriteteve per te respektuar praktikat e DQAF; LNO (*largely not observed*-shume e pa verejtur): ka mangesi te ndjeshme, si pasoje autoritetet duhet te ndermarrin hapat e duhur per te arritur zbatimin.

Pjesa me e madhe e indikatorëve të PEFA mbulon shtyllen e pare të Strategjise, permiresimin e cilesise se shpenzimeve publike. Indikatorët e PEFA kane perfshire gjithashtu edhe pjesen me te madhe te rekomandimeve te Raportit per Zbatimin e Kodeve dhe Standardeve (ROSC) te korrikut 2003 ne lidhje me transparencen fiskale.

### V.2.2 Zgjerimi i bazes tatimore dhe perputhja e politikës së taksave me perparësitë kombëtare.

Angazhimet ne kuader te MSA-se perbejne bazen e standarteve dhe te procesit te monitorimit per kete grup politikash. Pervec ketyre, prioritet eshte formimi i nje baze te dhenash per analizen e sistemit aktual te taksave dhe zhvillimin e nje strategjie gjithepershiresë dhe transparente per politikën e taksave.

Te rendesishem jane gjithashtu dhe indikatorët qe lidhen me objektivin strategjik te formulimit te politikave tatimore qe mbeshtesin krijimin e nje klime te favorshme per zhvillimin e biznesit.

Tabela V.2 Indikatorët qe lidhen me politikën e taksave

	Indikator	Perberja	Burimi aktual	Burimi I ardhshem	Vlera
MCC	Indeksi I politikës së taksave		MCA		Vlera ne perfundim te programit
ROSC 1	Qartesia e roleve dhe e pergjegjesive	1.1 Kuadri rregullator per zhvillimin e aktivitetit ekonomik 1.2 Formulimi dhe zbatimi I legjislacionit tatimor	ROSC	ROSC	Legjislacioni tatimor eshte i qarte ne vija ne te pergjithshme, por disa nga dispozitat nuk jane te percaktuara qarte.
Te tjere	Numri i taksave qe duhet te paguajne bizneset				
Te tjere	Numri i ndryshimeve te legjislacionit tatimor Brenda nje viti				

### V.2.3 Modernizimi i menaxhimit të borxhit publik

Informacioni baze per monitorimin e ketyre fushave eshte: borxhi i qeverise qendrore, borxhi i brendshem (i klasifikuar ne baze te financuesve dhe instrumentave), dhe borxhi i jashtem (sipas valutave, financuesve dhe instrumentave).

Tabela V.3 Indikatoret qe lidhen me menaxhimin e borxhit publik

Indikatori	Perberja	Burimi aktual	Burimi i ardhshem	Vlera 2006	Objektivi 2009
Borxhi ndaj PBB; Borxhi I brendshem ndaj PBB; Borxhi I jashtem ndaj PBB		Ministria e Financave	Ministria e Financave	54.97%; 38.78%; 16.19%	54.2%; 36.64%; 17.56%
Borxhi I brendshem ndaj totalit (Borxhi i jashtem ndaj totalit)		Ministria e Financave	Ministria e Financave	70.55% (29.45%)	67.6% (32.4%)
Borxhi afatgjate/Stoku i borxhit te brendshem		Ministria e Financave	Ministria e Financave	22%	58%
Kostoja e sherbimit te borxhit ndaj PBB		Ministria e Financave	Ministria e Financave	3.29%	3.64%
Maturimi mesatar		Ministria e Financave	Ministria e Financave	242 dite	450 dite
PEFA-6 Informacion gjithepershires ne dokumentat e buxhetit	Financimi I deficit, pershkrimi I komponenteve ne buxhet	PEFA	PEFA	Financimi I deficitit ndahet vetem ne te huaj dhe te brendshem. (plotesohet)	
PEFA-12 Perspektiva shumevjecare e planifikimit fiskal, politikes se shpenzimeve dhe e buxhetimit.	Shtirirja dhe frekuenca e analizave te qendrueshmerise se borxhit	PEFA	PEFA	C	
PEFA-17 Regjistrimi dhe menaxhimi I bilanceve te arkes, borxhit dhe garancive.	Cilesia e regjistrimit dhe raportimeve te te dhenave te borxhit Sistemet e kontraktimit te huave dhe leshimit te garancive	PEFA	PEFA	B B	

Vleresimet ne kete fushe do te lidhen me progresin e bere ne drejtim te pakesimit te nivelit te borxhit te brendshem ne raport me PBB-ne, diversifikimin dhe nderkombetarizimin, dhe masen ne te cilen te gjitha keto lidhen me uljen e kostove te sherbimit te borxhit. Nje matje e perafert do te jete shkalla e aderences se Ministrise se Financave me Sistemin e Integruar te Menaxhimit te borxhit qe do te kompletohet se afermi. Kjo do te duhet te shoqerohet me nje vleresim rezultatesh, pasi skema e re te kete filluar zbatimin.

#### V.2.4 Forcimi i performances dhe besueshmerise se administratave tatimore dhe doganore.

Ne kete fushe te rendesishem jane indikatoret PEFA dhe ata qe rrjedhin nga zbatimi i MSA.

Tabela V.4 Indikatoret qe lidhen me performancen e administratave tatimore dhe doganore

	Indikatori	Performanca aktuale	Burimi aktual	Vlera 2006	Target
PEFA-13	Transparenca e detyrimeve te taksapaguesve.	N/A	PEFA	N/A	
PEFA-14	Efektiviteti I procedurave per regjistrimin e taksapaguesve dhe vleresimit te detyrimeve tatimore.	N/A	PEFA	N/A	
PEFA-15	Efektiviteti ne mbledhjen e taksave.	N/A	PEFA	N/A	
ROSC	Mbrojtja e administratave tatimore dhe doganore nga nderhyrjet e politikës		ROSC	Formalisht, dy administratave I eshte dhene mbrojtja e duhur ligjore, por kjo demtohet nga dispozita ligjore tatimore te keq percaktuara.	
MCC	Indeksi I politikës se taksave		MCA	-0,89	-6,53
MCC	"Tax buoyancy" = %Δ T / % Δ GDP	TVSH	MCA	1,65	> 1,65
		T. fitimi		0,97	> 1,00
		T. ardhurat personale		0,44	> 1,00
Te tjere	Hendeku tatimor=1-te ardhurat e mbledhura/te ardhurat e mbledhshme potenciale		Tatime/Dogana		
Te tjere	Numri I deklarave tatimore te dorezuara/numri I taksapaguesve te regjistruar		Tatime/Dogana		
Te tjere	Shuma e taksave te paguara vullnetarisht/Shuma e taksave te pagueshme ne baze te deklarave tatimore.		Tatime/Dogana		
Te tjere	Numri I rasteve te evazionit, mashtrimit doganor dhe kontrabandes te kapura dhe gjykuara cdo vit.		Tatime/Dogana		
Te tjere	Taksat shtese te vleresuara pas kontrolleve tatimore/detyrimet tatimore te deklaruar		Tatime/Dogana		
Te tjere	Mesatarja e diteve te nevojshme per te identifikuar dhe njoftuar deklaruesit e vonshem, mos deklaruesit dhe ata qe deklarojne me pak detyrime tatimore sesa duhet.		Tatime/Dogana		
Te tjere	Kostot administrative/Te ardhurat e mbledhura total		Tatime/Dogana		
Te tjere	Numri I taksapaguesve/Numri I punonjesve tatimore		Tatime/Dogana		
Te tjere	Kostot direkte dhe indirekte te shlyerjes se detyrimeve nga tatimpaguesit		Tatime/Dogana		
Te tjere	Koha qe shpenzohet nga bizneset per pagimin e taksave; numri i taksave qe paguhen on-line				
Te tjere	Numri i kontrolleve tatimore qe kryhen ne nje vit tek nje biznes; koha mesatare e zgjatjes se nje auditimi				
Te tjere	Koha mesatare e rimbursimit te TVSH, per bizneset eksportuese dhe ato jo-eksportuese				

Perkufizime: *N/A-not applicable*: e pa klasifikuar

Aktualisht, DPT dhe DPD nuk perdorin asnje lloj indikatori per matjen e performances, pervec objekivit te mbledhjes se te ardhurave te planifikuara, te vendosur nga Qeveria. Ka nje nevoje urgjente per percaktimin e indikatoreve te pershtatshem qe Agjencite e te ardhurave dhe vete Qeveria do te perdorin per monitorimin e performances kundrejt objektivave.

Raporti i PEFA 2006 nuk jep asnje vleresim per indikoret 13, 14, dhe 15, qe lidhen me administrimin e te ardhurave, per shkak te informacionit te pamjaftueshem. Prandaj, nje nga prioritetet e Strategjise ne lidhje me vleresimin dhe monitorimin eshte te siguroje qe te dhena te besueshme per keto fusha te behen te disponueshme.

Sistemi i Integruar Tatimor qe do te vendoset me asistencen e BE-se do te permbaje edhe funksionet e Sistemit te Menaxhimit te Informacionit (MIS), qe do te vendoset ne kuadrin e MCA. MIS do te perfshije dhe vendosjen e objektivave per te gjitha sektoret e punes se administrates tatimore, indikoret e performances, matjen e performances dhe menytrat e raportimit.

Ne lidhje me grupin e indikatoreve “te tjere”, behet fjale per indikore potenciale (lista nuk eshte e kompletuar por vetem nje paraqitje e disa prej tyre) qe do te duhet te merren ne konsiderate dhe te perdoren (te gjitha, disa prej tyre ose te tjere) nga administratat tatimore dhe doganore per matjen e eficences dhe efektivitetit ne menaxhimin dhe mbledhjen e te ardhurave. Koha e adoptimit te tyre do te varet nga baza e te dhenave qe keto administrata do te jene ne gjendje te grumbullojne dhe menaxhojne si dhe nga kapacitetet per matjen dhe monitorimin e tyre.

### V.3 Pergjegjeshmeria

Angazhimi i Qeverise ne procese si PEFA, PEIR dhe ROSC, dhe transparenca e ketyre dokumenteve luan rol te rendesishem ne te qenit nje qeveri transparente dhe e pergjegjshme. Pergjegjshmeria e financave publike do te perforcohet dhe nga dispozitat e ligjit te ri Organik te Buxhetit qe do te aprovohet se shpejti si dhe nga forcimi i strandarteve te raportimit dhe auditimit.

Pritet gjithashtu qe edhe vete strategjia sektoriale te sherbeje per te rritur pergjegjshmerine. Ne versionin e saj final, kjo strategji perfshin kontributet e Keshillit te Ministrave, Ministrise se Ekonomise, Bankes se Shqiperise, donatoreve dhe partnereve ne zhvillim, dhe aktoreve te tjere te interesit qe jane perfshire ne fazen e konsultimeve. Eshte menduar qe strategjia te shperndahet dhe te behet e njohur ne shkalle te gjere, nepermjet publikimit te saj ne faqet e internetit te organizatave te pefshira ne te.